



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/156
Datë: 23.08.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 gusht 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Kodin e Procedurës Civile.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë -Ministarstvo Pravde - Ministry Of Justice

**KONCEPT DOKUMENTI PËR KODIN E PROCEDURËS CIVILE TË
KOSOVËS**

Gusht, 2023

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	4
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit	6
Kapitulli 2: Objektivat	31
Kapitulli 3: Opsionet	31
Kapitulli 3.1: Asnjë ndryshim (Ruajtja e Status Quo-së)	34
Kapitulli 3.2: Përmirësimi i ligjeve të veçanta procedurale civile pa kodifikim	34
Kapitulli 3.3: Hartimi i Kodit të Procedurës Civile të Kosovës	35
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	37
Kapitulli 4.1: Sfida në mbledhjen e të dhënave	38
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	39
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	40
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për alternativat e ndryshme	40
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet	44
Kapitulli 7: Përfundimet dhe vizioni për strukturën e Kodit të Procedurës Civile të Kosovës	45
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik	48
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore	50
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore	53
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore	55

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti për Kodin e Procedurës Civile të Kosovës
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë, Departamenti Ligjor
Personi kontaktues	Isuf Jahmurataj, Zyrtarë i Lartë Ligjor, Departamenti Ligjor, Ministria e Drejtësisë. Tel: 67 085
PKZH	Qëllimi zhvillimor: Shtylla e tretë: Siguria dhe Sundimi i ligjit – 9. Drejtësi efektive Qëllimi strategjik: 9.1 Drejtësi me kohë dhe 9.4 Qasje e mirëfilltë në drejtësi
Prioriteti strategjik	Ky koncept dokument është i paraparë në listën e koncept dokumenteve për vitin 2023

Vendimi	
Çështja kryesore	Mungesa e një legjislacioni të kodifikuar, unifikuar (konsoliduar) dhe të harmonizuar për përcaktimin e rregullave ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, tregtare, ekonomike apo administrative paraqet nevojën për kodifikimin, përmirësimin e normave ekzistuese dhe përditësimin e tyre me standardet më të mira ndërkombëtare.
Përmbledhje e konsultimeve	Nga konsultimet paraprake dhe ato me publikun nuk ka pasur çështje që kanë qenë kontestuese. Konsultimet me publikun kanë filluar nga data 04.05.2023 deri me 25.05.2023 Konsultimet paraprake kanë filluar nga data 04.04.2023 deri me 25.04.2023 Komente kanë ofruar: SKQ/ZKM, OSBE, USAID, Zyra e Bashkimit European. Komentet janë të përmbledhura në një tabelë, ku aty janë vendosur komentet konkrete dhe arsyetimi për pranimin apo mos pranimin e tyre (bashkëlidhur me Koncept dokumentin).
Opsioni i propozuar	Miratimi i Kodit të Procedurës Civile

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Zbatohet në kuadër të kufijve aktual buxhetor.
Ndikimet ekonomike	Do të ndihmojë në qartësinë e normave procedurale dhe shpejtësinë e gjykimit dhe zgjidhjes së konflikteve civile dhe administrative duke dhënë më shumë siguri edhe për marrëdhëniet ekonomike.

Ndikimet shoqërore	Do të ndikojë ndjeshëm në qasjen në drejtësi.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ndikimet ndër-sektoriale	Nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Nuk vlenë.
Testi i NVM-ve	Testi i NVM-së nuk është aplikuar sepse ky koncept dokument trajton çështje që nuk janë relevante për NVM-të.

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hartimi i Kodit të Procedurës Civile
Afatmesëm	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i Kodit të Procedurës Civile; • Trajnimi i gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjerë të së drejtës që do të zbatojnë normat e Kodit të Procedurës Civile.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Kodin e Procedurës Civile të Kosovës
Ministria bartëse	Ministria e Drejtësisë, Departamenti Ligjor
Personi kontaktues	Isuf Jahmurataj, 67 085
PKZH	Qëllimi zhvillimor: Shtylla e tretë: Siguria dhe Sundimi i ligjit – 9. Drejtësi efektive Qëllimi strategjik: 9.1 Drejtësi me kohë dhe 9.4 Qasje e mirëfilltë në drejtësi
Prioriteti strategjik	Ky koncept dokument është i paraparë në listën e koncept dokumenteve për vitin 2023
Grupi punues	<ol style="list-style-type: none"> 1. Isuf Jahmurataj, Kryesues, MD 2. Ruzhdi Osmani, Zëvendës Kryesues, MD 3. Albert Zogaj, Kryesues i KGJK 4. Qerim Ademaj, Zëvendëskryesues i KGJK 5. Fejzullah Rexhepi, Gjyqtar, Gjykata Supreme 6. Rrustem Thaqi, Gjyqtar, Gjykatën Supreme 7. Zenel Leku, Gjyqtar, Gjykata Supreme 8. Nenad Laziq, Gjyqtar, Gjykata Supreme 9. Arsim Hamzaj, Gjyqtar, Gjykata e Apelit 10. Hidajete Gashi, Gjyqtar, Gjykata e Apelit 11. Franciska Ymeri Zhitia, Gjyqtar, Gjykata e Apelit 12. Eros Gashi, Keshilltar Politik, MD

	13. Florent Spahija, Keshilltar i jashtëm Politik, MD 14. Trëndelina Qorraj, Zyrtare për Integrim European, MD 15. Albulena Uka, Zyrtare e Larte Ligjore, MD 16. Florentina Beqiraj, Kordinatore e njësisë per te drejtat e njeriut, MD 17. Hajrije Zogaj, Zyretare e Larte per Buxhet, MD 18. Saranda Salihu, Zv. Udheheqese e ZKP, MD 19. Vjosa Hoxha, Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave SKQ/ZKM 20. Kushtrim Canolli, Zyrtar i Larte për Planifikim të Politikave ZPS/ZKM 21. Alberita Hyseni, Zyrtare e Lartë Ligjore, ZL/ZKM 22. Gëzim Bislimi, Analist i Lartë i Buxhetit/MFPT 23. Vyrtyte Gervalla/BIRN
Informata shtesë	

1. Hyrje

Drejtësia civile përfshihet në sferën e veprimtarisë shtetërore, që synon zgjidhjen paqësore, të detyrueshme, nëpërmjet ligjit, të mosmarrëveshjeve që kanë aktorët e ndryshëm që veprojnë në një shtet të caktuar, me qëllimin final të shmangies së vetëgjyqësisë apo trazimit të paqes sociale. Normat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e dhënies së drejtësisë civile, gjenden në të ashtuquajturin legjislacion procedural civil. Ky legjislacion rregullon të gjitha fazat e drejtësisë civile, duke filluar nga organizimi strukturor i drejtësisë civile, fenomenet e ndryshme që ndodhin para se të paraqitet një padi në gjykatë (p.sh: llojet e provave që mund të paraqiten në gjyq), duke vijuar me rregullat për paraqitjen e padisë, kushtet formale të saj, kompetencën e gjykatës, pozitën dhe të drejtat e palëve dhe përfaqësuesve të tyre, mjetet e provës, afatet dhe rregullat e tjera për drejtimin dhe përfundimin e procesit gjyqësor civil, vendimet e ndryshme që merr gjykata gjatë vijimit dhe në përfundim të gjykimit, të drejtën e ankimit të palëve e deri tek procesi përmbarrimor. Ky i fundit është faza kulmore e vënies në vend të të drejtave civile të palëve dhe pasqyron më së miri forcën shtrënguese të shtetit në veprim.

Sa më të qarta, lehtësisht të qasshme, të shkruara thjesht dhe të sistemuara të jenë normat procedurale civile, aq më e mundshme është për përdoruesit e shërbimeve gjyqësore që të kenë qasje të barabartë dhe efikase në drejtësinë civile. Kjo pasi normat ligjore nuk i drejtohen vetëm profesionistëve të së drejtës, por mbi të gjitha normojnë ushtrimin e të drejtave nga palët, të cilat për vetë kuptimin që ka fjala palë, mund të jenë kushdo (individ, grup interesi apo person juridik, vendas apo i huaj ose pa shtetësi) që ka një mosmarrëveshje dhe kërkon ta zgjidhë nëpërmjet sistemit të drejtësisë, e cila është një nga prerogativat më të rëndësishme shtetërore. Përpjekjet për krijimin e një korpusi normash ligjore datojnë që në lashtësi, ku mund të

përmendim p.sh: Ligjin e 12 Tabelave (viti 450 para Krishtit), i cili u miratua në Romën e Lashtë. Ajo që dihet është se libri i parë i këtyre 12 tabelave, fliste për procedurën civile e konkretisht për mundësinë për të marrë drejtësi civile nga një magjistrat romak.¹ Shekujt e fundit shumica e vendeve të traditës së të drejtës civile (familja Romano-Gjermanike), kanë Kodifikuar rregullat e procedurës civile, me qëllim sistemimin e tyre në një akt të vetëm ligjor, i cili i vjen në ndihmë jo vetëm profesionistëve të së drejtës, por edhe çdo “konsumatori” të drejtësisë civile.

Legjislacioni procedural civil në Kosovë përbëhet nga një sërë ligjesh të cilat rregullojnë aspekte të caktuara të procesit gjyqësor civil. Mes tyre përmendim ligjin nr. 03/L-006 “Për procedurën kontestimore”, ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-118 “Për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 03/L-006 “Për procedurën kontestimore”; ligjin nr. 03/L-007 “Për Procedurën Jokontestimore”, i ndryshuar me ligjin nr.06/L-007 “Për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 03/L-007 “Për Procedurën Jokontestimore”; ligjin nr. 04/L-139 “Për Procedurën Përmbarimore”, i ndryshuar me ligjin nr. 05/L-118 “Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 “Për Procedurën Përmbarimore”. Këto janë përgjithësisht akte të hartuara nën influencën e legjislacionit të ish-Jugosllavisë.² Por, pas vitesh si një shtet i pavarur dhe pasi ka fituar identitetin dhe karakteristikat e saj edhe në drejtim të sistemit institucional e ligjor, është e nevojshme që Kosova të reformojë rregullat procedurale dhe të reflektojë standardet më të mira ndërkombëtare njëherësh duke integruar edhe zhvillimin e praktikës së brendshme dhe nevojat e identifikuar nga praktikuesit e së drejtës.

Normat procedurale përgjithësisht janë një mjet i rëndësishëm për funksionimin e sistemit ligjor në tërësi. Studiuesit kanë evidentuar një rol të dyfishtë të këtyre normave: nga njëra anë ato synojnë gjykimin e drejtë, ekonomik dhe të shpejtë e në përputhje me ligjin për ato mosmarrëveshje që palët zgjedhin t’i zgjidhin gjyqësisht dhe nga ana tjetër, ato sigurojnë një instrument për gjyqtarët për të ushtruar funksionin e tyre drejt interpretimit, qartësisht, zhvillimit dhe sigurisht zbatimit të ligjit.³ Andaj, qartësia dhe efikasiteti i këtyre normave është me rëndësi për funksionimin e shtetit të së drejtës.

Në shumë vende (Holanda, Mbretëria e Bashkuar, Zvicra, apo shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore)⁴, normat procedurale civile i janë nënshtruar rishikimit për të rritur efikasitetin e tyre. Së fundi, nga vendet e rajonit të Ballkanit edhe Shqipëria ka ndërmarrë një reformë rrënjësore në drejtësi e cila diktoi nevojën për reformimin edhe të kuadrit rregullues procedural civil. Kodi i Procedurës Civile i është nënshtruar pas miratimit të Reformës në Drejtësi disa ndryshimeve në nëntor 2016, mars 2017 dhe mars 2021, të cilat kanë synuar rritjen e performancës së gjykatave, thjeshtimin e procedurave gjyqësore, krijimin e një mekanizmi ligjor për adresimin e problematikës së gjykimin të çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, forcimin e

¹ The Dynamism of Civil Procedure – Global Trends and Developments. Guy I. Seidman. Springer, 2016. f. 6.

² Koncept Dokumenti për Procedurën Kontestimore, miratuar me vendimin Nr. 09/77, datë 4.12.2018.

³ Jolovicz, ‘On Civil Procedure’, at pp. 70, 71., cituar në Common minimum standards of civil procedure, nga Blomeyer & Sanz: Magdalena Tulibacka, Margarita Sanz, Roland Blomeyer, 2016, f. 21.

⁴ A. Uzelac, Goals of Civil Justice and Civil Procedure’, at p. 6, cituar në Common minimum standards of civil procedure, nga Blomeyer & Sanz: Magdalena Tulibacka, Margarita Sanz, Roland Blomeyer, 2016, f. 21.

rregullave për njoftimin elektronik të palëve, saktësimin dhe reformimin e procedurave të zakonshme dhe të posaçme të gjykimit në shkallët e ankimit (gjykatë apeli dhe Gjykata e Lartë), etj.

Në kuadrin e këtyre reformimeve, edhe kuadri aktual rregullues i normave procedurale civile në Kosovë duhet t'i nënshtrohet reformimit jo vetëm për të dhënë zgjidhje ndaj problematikave të ndeshura gjatë zbatimit në praktike, por edhe për të reflektuar standardet ndërkombëtare që sigurojnë qasje në drejtësi.

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Problemi kryesor: Mungesa e një legjislacioni të kodifikuar, të unifikuar (konsoliduar) dhe të harmonizuar për përcaktimin e rregullave ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, tregtare, ekonomike apo administrative. Njëherësh, nga problematikat e evidentuara nga zbatimi aktual i ligjeve procedurale lind nevoja për përmirësimin e normave ekzistuese si dhe përditësimin e tyre me standardet më të mira ndërkombëtare në sferën e procedurës civile.

1. Nevoja për reformim ligjor në ligjet procedurale civile në përfrim me standardet Europiane të procedurës civile.

Nevoja për përfrim të legjislacionit procedural civil të Kosovës me standardet më të mira Europiane buron nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 22) dhe ligji Nr. 05/L-069 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Kosovës, nga njërën anë dhe Bashkimit Europian dhe Komunitetit Europian të Energjisë Atomike, në anën tjetër" (nenet 1(2)(a)(d), 4, 74, 83).

Nisma për të reformuar legjislacionin procedural në Kosovë ka nisur më herët dhe disa nga nevojat për ndërhyrje janë evidentuar edhe në koncept dokumentin "Për procedurën kontestimore" të miratuar në datën 4.12.2018, me vendimin nr. 09/77. Ky dokument ka evidentuar disa nga problematikat dhe nevojat për ndryshimin e ligjit "Për procedurën kontestimore" si nevojë për t'u përfruar me standardet europiane dhe për të modernizuar këto ligje të cilat në një masë të madhe kanë qenë të ndikuara nga ligjet e ish-Jugosllavisë. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh që përpos harmonizimit të këtyre normave përgjithësisht, si rezultat i proceseve integruese në strukturat europiane, procedura civile është "thellësisht e mishëruar në organizimin politik, strukturën ekonomike, në identitetin kushtetues e social të një kombi si dhe marrëveshjeve për shpërndarjen e pasurisë".⁵ Në këtë sfond, është themelore që edhe rregullat

⁵ M.Tulibacka, 'Europeanisation', at p. 1532, cituar në Common minimum standards of civil procedure, nga Blomeyer & Sanz: Magdalena Tulibacka, Margarita Sanz, Roland Blomeyer, 2016, f. 23.

procedurale civile të reflektojnë këto elemente e të bëhen shprehëse të identitetit kombëtar të vendit që i integron duke ruajtur një standard minimal përafrimi të nevojshëm në funksion të shkëmbimit më të madh me të cilin ndeshemi sot.

Ky reformim tërësor është duke prekur edhe sfera të tjera të rregullimit ligjor në Kosovë ku përmendim nismat për të ndryshuar ndjeshëm jo vetëm ligjet procedurale (tashmë është miratuar Kodi i Procedurës Penale të Kosovës), por edhe ato materiale. Reforma për miratimin e Kodit të Procedurës Civile apo puna për hartimin e Kodit Civil janë tregues të përpjekjeve për të konsoliduar edhe më shumë kuadrin rregullues të brendshëm.

Nevoja për reformim gjithashtu është theksuar në mënyrë të përsëritur nga Raportet për Vendin të Komisionit Evropian të hartuara për Kosovën, të cilat në mënyrë të vazhdueshme kanë vënë theksin tek rritja e efikasitetit në sistemin gjyqësor pasi është konstatuar një nivel i ulët i kapaciteteve gjyqësore për të gjykuar çështjet brenda afatit.⁶ Në vijim, përgjithësisht Raportet për Vendin kanë konstatuar se administrimi i drejtësisë ka vijuar të jetë i ngadaltë, inefficent dhe i ndikueshëm nga ndikime të papërshtatshme.⁷ Bashkë me këto konstatime, këto raporte kanë lënë detyrën për të reduktuar ngarkesën e çështjeve bazuar në një plan të rishikuar dhe një strategji për digjitalizimin⁸. Në këtë kontekst, një rol më rëndësor në reduktimin e backlog-ut të çështjeve luan edhe përcaktimi i rregullave procedurale që synojnë të japin shpejtësi procesit gjyqësor. Ndaj, reformimi i normave procedurale civile duhet të synojë edhe krijimin e mekanizmave për të gjykuar më shpejt.

Raporti ka nënvijëzuar nevojën për gjykim më të shpejtë, pasi koha që merr gjykimi i çështjeve (nga dita e paraqitjes së padisë deri në marrjen e një vendimi) është shqetësuese pasi është tejet e gjatë. Në 2021, koha e gjykimit për çështjet civile dhe tregtare në gjykimin në shkallën e parë është 1339 ditë dhe 798 ditë për çështjet administrative. Në gjykimin në apel, çështjet civile dhe tregtare gjykohen brenda një afati 646 ditor ndërsa ato administrative 426 ditor.⁹ Këto vonesa, janë bërë shkak për ankesa që qytetarët kanë paraqitur pranë Avokatit të Popullit dhe në eventualitetin që Kosova do të bëhet pjesë e Këshillit të Europës, mund të bëhen shkak për gjykime kundër saj në shkelje të afatit të arsyeshëm, sipas Nenit 6(1) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Përpos këtyre nevojave njëherësh, duke qenë një reformë që po përgatitet në kohën e zhvillimeve të mëdha teknologjike, është e udhës që edhe në drejtim të procesit gjyqësor të integrohet përdorimi i mjeteve të teknologjisë elektronike (e njohur edhe si e-justice). Në këtë drejtim, një rregullim më i mirë i provave elektronike apo edhe rregullimi i seancave në distancë do të ndihmojë ndjeshëm në gjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm. Prandaj, në këtë drejtim Raportet për Vendin i Komisionit Evropian për Kosovën, thekson

⁶ Raport Progresi i Kosovës 2021, f. 16, Raport Progresi i Kosovës 2022, f. 16.

⁷ Raport Progresi i Kosovës, 2022, f. 16.

⁸ Ibid., f. 16.

⁹ Raport Progresi i Kosovës, 2022, f. 22.

nevojën për të përmirësuar përdorimin e teknologjisë digjitale dhe miratimin e ndryshimeve të nevojshme për zhvillimin e seancave në distancë.¹⁰

Ligjet kryesore që normojnë rregulla të procedurës civile dhe që preken nga ky koncept dokument janë si vijon:

1. Ligji nr. 03/L-006 "Për procedurën kontestimore".
2. Ligji nr. 04/L-118 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 03/L-006 "Për procedurën kontestimore".
3. Ligji nr. 03/L-007 "Për Procedurën Jokontestimore".
4. Ligjin nr.06/L-007 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 03/L-007 "Për Procedurën Jokontestimore".
5. Ligji nr. 04/L-139 "Për Procedurën Përmbartimore".
6. Ligji nr. 05/L-118 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 "Për Procedurën Përmbartimore".
7. Ligji nr. 2004/26 "Ligji mbi Trashëgiminë e Kosovës" (nenet 76-80).

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nënligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji nr. 03/L-006 "Për procedurën kontestimore".	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2583	Ministria e Drejtësisë Gjykatat	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit
Ligji nr. 04/L-118 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 03/L-006 "Për	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2849	Ministria e Drejtësisë	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit

¹⁰ Raport Progresi i Kosovës, 2022, f.17.

procedurën kontestimore”.		Gjykatat	Zbatimi i legjislacionit
Ligji nr. 03/L-007 “Për Procedurën Jokontestimore”.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2608	Ministria e Drejtësisë Gjykatat	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit
Ligjin nr.06/L-007 “Për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 03/L-007 “Për Procedurën Jokontestimore”.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18304	Ministria e Drejtësisë Gjykatat	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit
Ligji nr. 04/L-139 “Për Procedurën Përmbartimore”.	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2870	Ministria e Drejtësisë Gjykatat Përmbartuesit	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit
Ligji nr. 05/L-	https://gzk.rks-	Ministria e	Hartimi i

118 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 "Për Procedurën Përmbaremore".	gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14673	Drejtësisë Gjykatat Përmbaresit	legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit
Ligji nr. 2004/26 "Ligji mbi Trashëgiminë e Kosovës" (nenet 76-80).	https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2407	Ministria e Drejtësisë Gjykatat	Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit Zbatimi i legjislacionit

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	Vështirësi në qasjen e profesionistëve dhe publikut në legjislacionin e konsoliduar procedural civil.
Problemi kryesor	Mungesa e një legjislacioni të kodifikuar, të unifikuar (konsoliduar) dhe të harmonizuar për përcaktimin e rregullave ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, tregtare, ekonomike apo administrative, si dhe nevoja për përmirësimin e normave ekzistuese dhe përditësimi i tyre me standardet më të mira ndërkombëtare në sferën e procedurës civile.
Shkaqet	Shpërndarja e normave procedurale në shumë ligje të veçanta. Tradita e mëparshme e hartimit të ligjeve të veçanta për segmente të ndryshme të procedurës civile. Mos përshtatja e legjislacionit procedural civil me ndryshimet teknologjike të kohës. Mungesa e kodifikimit në lëndën e procedurës civile për dallim nga ajo në procedurën penale.

--	--

Problemi kryesor

Siç parashtrohet në tabelën e mësipërme, problemi kryesor me të cilin përballet sektori i drejtësisë civile në Kosovë, është mungesa e një legjislacionit të kodifikuar, të konsoliduar dhe të harmonizuar për përcaktimin e rregullave procedurale civile. Ligjet aktuale që normojnë pjesë të shpëputura të procedurave gjyqësore civile (p.sh: procedurat kontestimore, jokontestimore apo përmbartimore), përmbajnë rregullime ligjore që pasjellin përsëritjen e panevojshme të instituteve apo parimeve të ndryshme procedurale civile, rregullimin eklektik dhe nganjëherë të pa harmonizuar të rregullave procedurale, si dhe mos qenien e disa instituteve procedurale në harmoni me të drejtën Europiane, e veçanërisht të drejtën e Bashkimit Europian (p.sh: procedura për lëshimin e urdhërpagesës, apo gjykimi i padive me vlera të vogla).

Shkaqet

Shkak i drejtpërdrejtë i kësaj problematike kryesore, është shpërndarja e rregullave procedurale në disa ligje të ndryshme, të hartuar në periudha të ndryshme dhe nga grupe pune jo të njëjta. Po ashtu, kjo ka ardhur edhe për shkak traditës ligjore të mëparshme. Vihet re një mos evoluim i legjislacionit procedural civil, veçanërisht në lidhje me adoptimin e teknologjive të reja të informacionit, që ka të bëjë me njoftimet elektronike, seancat gjyqësore në distancë, etj. Po ashtu, lënda e procedurës civile nuk është në të njëjtën kahje zhvillimi me atë procedurale penale, e cila tashmë është kodifikuar në një Kod të Procedurës Penale. Edhe legjislacioni kryesor civil është në fazën e Kodifikimit, nëpërmjet Projekt Kodit Civil të Kosovës, i cili është në faza të avancuara të miratimit.

Efektet

Efektet që vijnë nga mungesa e Kodit të Procedurës Civile të Kosovës, lidhen me vështirësinë e shtuar jo vetëm për profesionistët e fushës, por edhe për publikun e gjerë, në lidhje me përdorimin dhe njohjen efektive të rregullave procedurale civile. Kjo veçanërisht në kushtet kur në Kosovë, sa i përket gjykimit në fakt, nuk është i detyrueshëm përfaqësimi me avokat i palëve. Kjo pasjell nevojën dhe efektin që qasja në drejtësi dhe qasja në rregullat procedurale që kushtëzojnë qasjen në drejtësi, të jetë sa më e plotë dhe efektive. Grupimi i rregullave procedurale në një akt të vetëm, për të gjitha fazat e procesit gjyqësor civil, do të zbusë efektin negativ që ka rregullimi aktual i shpërndarë i lëndës procedurale civile.

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuar. Gjithashtu, tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura.

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala	Efektet me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Ministria e Drejtësisë	Përgjegjëse për përmirësimin e qasjes në drejtësi për të gjithë qytetarët	Përmirësimi në qasjen në legjislacionin procedural civil.	Hartues i politikave ligjore për sektorin e drejtësisë
Këshilli i Gjyqësor i Kosovës	Është administrues i drejtësisë në vend	Mbikëqyrja e zbatimit eficient të procedurave gjyqësore civile.	Zbaton politikat e hartuara në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore
Akademia e Drejtësisë	Përgjegjëse për ngritjen e profesionalizmit të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës	Organizon trajnime në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të ligjeve procedural civile.	Zhvillon trajnime specifike për gjyqtarë dhe staf mbështetës në përputhje me nevojat e politikave.
Gjykatat e të gjitha niveleve dhe juridiksioneve	Zbatojnë normat procedurale civile	Zhvillojnë jurisprudencë në lidhje me kuptimin e normave të ndryshme procedurale civile, me interes për publikun dhe profesionistët e të drejtës.	Gjykatat janë përgjegjëse për zbatimin e rregullave procedurale civile, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor për palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedure.

2. Standardet Europiane në fushën e procedurës civile

Duhet theksuar që në fillim se legjislacioni aktual procedural civil i Kosovës ka tashmë të inkorporuar shumë nga standardet më të mira të pranuar në Europë, sa i përket rregullave të ndershme të procedurës civile. Nevoja për rafinim dhe përmirësim të legjislacionit procedural është një konstante e përhershme jo vetëm në Kosovë, por edhe në çdo vend tjetër që ka rregulla ligjore në procedurën civile, pasi dinamika e zhvillimit shoqëror është e tillë që nevojitet herë pas here përshtatja e legjislacionit me risitë që sjell zhvillimi shoqëror dhe teknologjik.

Sa i përket Bashkimit European nuk ka një instrument të vetëm, i cili të rregullojë standardet e procedurës civile. Procedura civile ka qenë për shumë kohë dhe vijon të jetë ende në pjesën e saj më të madhe në domenin ekskluziv të shteteve të ndryshme europiane. Sistemi i normave të procedurës civile në nivel mbishtetëror në Europë përbëhet nga tërësia e standardeve që janë përfshirë në Traktatet e Bashkimit European, parimet e Kartës Themelore të të Drejtave të Njeriut, Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut si dhe jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European (GjDBE) si dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Ky legjislacion parësor është plotësuar edhe nga legjislacioni dytësor që përgjithësisht përfshin direktiva të miratuara në kuadër të politikës së bashkëpunimit gjyqësor.

Parashikimi konventor apo i traktateve është në formën e parimeve e nuk ka rregulla konkrete procedurale, por këto parime janë zbrëthyer në norma konkrete procedurale si nga legjislacioni dytësor ashtu edhe nga jurisprudenca e gjykatave të lartpërmendura.

Një nga parimet kryesore që është pjesë e akteve të lartpërmendura është edhe parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore. Traktati i Bashkimit European parashikon se "Shtetet Anëtarë duhet të sigurojnë mjetet e nevojshme për të garantuar mbrojtje efektive gjyqësore në fushat që mbulon e drejta e Bashkimit"¹¹. Kjo dispozitë i referohet strukturës së sistemit gjyqësor në Bashkimin European si dhe sistemeve gjyqësore kombëtare. Ky detyrim është ripërsëritur edhe nga neni 47 i Kartës Europiane së të Drejtave Themelore i cili parashikon se "Kushdo të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit ka të drejtë për një mjet efektiv përpara një gjykate në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë nen. Kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur e caktuar me ligj. Kushdo duhet të ketë mundësinë për t'u këshilluar, mbrojtur dhe përfaqësuar. Ndiurma juridike duhet t'u sigurohet atyre që nuk kanë burimet e mjaftueshme për aq sa kjo ndihmë është e nevojshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi"¹².

Nga ana tjetër dy dispozita me rëndësi dhe thuajse në të njëjtën linjë me këtë parashikim të Kartës janë nenet 6¹³ dhe 13¹⁴ të Konventës Europiane për të Drejtat e njeriut që rregullojnë procesin e rregullt ligjor dhe të drejtën për zgjidhje efektive. Neni 6(1) i Konventës përcakton se "1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në

¹¹ Neni 19(1), Traktati i Bashkimit European Official Journal of the European Union C 326/13.

¹² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>

¹³ Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. https://ëëë.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf

¹⁴ Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. https://ëëë.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf

proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë. [...]” Ndërsa neni 13 i Konventës përcakton detyrimin për shtetet anëtare për të parashikuar mjetet efektive përpara organeve kombëtare duke përcaktuar se “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Dallim mes këtyre instrumenteve qëndron në faktin se Karta zbatohet vetëm për aspekte të lidhura me zbatimin e së drejtës së Bashkimit, ndërsa Konventa ka një zbatim më të gjerë. Gjithsesi, këto të drejta nuk janë absolute, por mund të kufizohen, sipas testeve që kanë shtjelluar nga gjykatat përkatëse (Gjykata e Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Europian).

Përpos këtyre instrumenteve në Bashkimin Europian ekzistojnë një sërë aktesh legislative dytësore¹⁵ që përmbajnë norma procedurale civile, ku mund të përmendim, midis të tjerash:

1. Rregulloren (EU) Nr. 1215/2012 e Parlamentit dhe e Këshillit e 12 Dhjetorit 2012 mbi juridiksionin dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare (Bruksel I Recast).
2. Rregullorja e Këshillit (EC) nr. 1206/2001 e 28 Majit 2001 mbi bashkëpunimin midis gjykatave të Shteteve Anëtare në marrjen e provave në çështjet civile dhe tregtare (Rregullorja e Marrjes së Provave).
3. Rregullorja (EC) 1393/2007 e Parlamentit dhe e Këshillit Europian për dërgimin në Shtetet Anëtare të dokumenteve gjyqësorë dhe jashtëgjyqësorë në çështjet civile dhe tregtare (dërgimi i dokumenteve).
4. Rregullorja (EU) 805/2004 për krijimin e Urdhrit Europian për Ekzekutimin e Pretendimeve të Pakundërshtuara, OJ L (2004) 143/15 (Rregullorja e Ekzekutimit të Urdhrit Europian).
5. Rregullorja (EU) 1896/2006 për krijimin e procedurës për Urdhrit Europian të Pagesës, OJ L (2006) 399/1 (Rregullorja e Urdhrit Europian të Pagesës).
6. Rregullorja (EC) Nr. 861/2007 e Parlamentit dhe e Këshillit e datës 11 Korrik 2007 për krijimin e Procedurës për Padi të me Vlerë të Vogël, OJ L 199, 31.07.2007 (Rregullorja Europiane për Padi të me Vlerë të Vogël), etj.

Nga ana tjetër, një burim i rëndësishëm që do të duhet të mbahet parasysh në procesin e reformimit të procedurës civile, janë edhe rekomandimet dhe udhërrëfyesit e dhëna ndër vite nga Komiteti i Ministrave, i cili vepron sipas kompetencave që i njihen nga Statuti i Këshillit të Europës. Këto ofrojnë standarde të pranuar gjerësisht në Europë, të cilat ndihmojnë në kuadër të përmirësimit të dispozitave apo instituteve të ndryshme procedurale civile, që gjenden aktualisht të inkorporuara në ligjet e ndryshme që rregullojnë procedurën civile në Kosovë, e të

¹⁵ Këtu po përmendim vetëm disa nga aktet fillestare të miratuara pa renditur edhe aktet ndryshuese të tyre.

cilat duhet theksuar se në pjesën më të madhe të tyre janë në përputhje me këto rekomandime. Konkretisht, ndër aktet kryesore përmenden:

1. Rekomandimi R (84) 5 mbi parimet e procedurës civile që synojnë përmirësimin e funksionimit të drejtësisë.
2. Rekomandimin R (95) 5 që lidhet me krijimin dhe përmirësimin e funksionimit të sistemeve të apelimit dhe procedurave gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare.
3. Rekomandimin Rec(2001)2 që lidhet me formësimin dhe riformësimin në një mënyrë kosto-efektive të sistemeve gjyqësore dhe informacionit ligjor të këtyre sistemeve.
4. Rekomandimi Rec(2001)3 mbi dorëzimin tek qytetarët i dokumenteve gjyqësore dhe ligjore, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja.
5. Rekomandimi Rec(2003)15 mbi arkivimin e dokumenteve elektronike në sektorin ligjor.
6. Rekomandimi Rec(2003)16 mbi ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore në fushën e së drejtës administrative.
7. Rekomandimi Rec(2003)17 mbi ekzekutimin e detyrueshëm.
8. Rekomandimi Rec(2004)20 mbi rishikimin gjyqësor të akteve administrative.
9. Rekomandimi CM/REC(2009)12 mbi parimet në lidhje me personat e zhdukur dhe prezumimin e vdekjes.
10. Rekomandimi CM/Rec(2010)12 mbi gjyqtarët: pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë.
11. Rekomandimi CM/Rec(2012)11 mbi rolin e prokurorëve publikë jashtë sistemit të drejtësisë penale.
12. Udhërrëfyesi CM(2018)169 mbi provat elektronike në proceset civile dhe administrative.
13. Udhërrëfyesi i datës 16.06.2021 mbi mekanizmat e zgjidhjes online të mosmarrëveshjeve në çështjet gjyqësore civile dhe administrative.
14. Udhërrëfyesi i datës 31.03.2021 mbi efikasitetin dhe efektshmërinë e skemave të ndihmës ligjore në fushën e të drejtës civile dhe administrative, etj.

Një burim tjetër informacioni për rregullat dhe standardet e përbashkëta europiane në fushën e procedurës civile, që merret për bazë në këtë koncept dokument dhe që do të merret parasysh në përmirësimin eventuale të dispozitave të veçanta procedurale në të ardhmen, përbëjnë edhe Rregullat Europiane Model të Procedurës Civile të ELI/UNIDROIT, që janë miratuar nga Këshilli dhe Anëtarësia e ELI (Instituti Europian për të Drejtën) në verën e 2020, si dhe nga Këshilli Drejtues i organizatës UNIDROIT, në mbledhjen e dytë të sesionit të 99, në 23-25 Shtator 2020.

2.1. Standardet Europiane për mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit (Online Dispute Resolution)

Një nga kërkesat e kohëve moderne në të cilat jetojmë, është përshtatja e procedurës së dhënies së drejtësisë civile, me zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në shoqëri. Takimet virtuale (online) janë tashmë pjesë e jetës së përditshme të njerëzve dhe ka lindur nevoja që këto teknologji të inkorporohen edhe në procedurat gjyqësore. E-gjykata (e-Court) apo e-Drejtësia (e-Justice) janë tashmë kërkesa imperative të kohës, për shkak se potencialisht ofrojnë mekanizma të cilët shkurtojnë kohën, rrisin efikasitetin dhe ulin kostot e përdorimit të shërbimeve gjyqësore nga palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në proces. Në këtë drejtim udhërrëfyesi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës i miratuar më datë 16.06.2021 “mbi mekanizmat e zgjidhjes online të mosmarrëveshjeve në çështjet gjyqësore civile dhe administrative”, përbën një bazë mjaft të mirë për ndërtimin e sistemeve elektronike gjyqësore që do të bëjnë të mundur qasjen e palëve në e-Drejtësi. Ky udhërrëfyes është i mbështetur në jurisprudencën e GjEDNj dhe përbëhet nga disa parime themelore. Ndonëse Kosova nuk është ende pjesë e Këshillit të Europës, ajo ka pranuar zbatimin e Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudencën e GjEDNj, ndaj këto parime që lidhen me drejtësinë dixhitale, e që mbështeten në nenet 6 e 13 të KEDNj, paraqiten me interes të veçantë në reformën e legjislacionit procedural civil të Kosovës. Në vijim, po parashtrojmë përmbledhtazi parimet bazë që duhet të mbahen parasysh nga shtetet e ndryshme, në dizajnimin dhe përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit, në procedurat gjyqësore apo përmbarrimore.

Në këtë pjesë të koncept dokumentit do të përdoret shkurtimi ODR (Online Dispute Resolution) për teknologjinë elektronike të informacionit që mund të përdoret nga gjykatat për të zgjidhur apo ndihmuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme.

Sipas udhërrëfyesit, shtetet inkurajohen që të nxisin besimin dhe konfidencën në përdorimin e ODR, e cila nuk duhet në asnjë rast të krijojë barriera për qasjen e palëve në drejtësi. Procedurat gjyqësore që zbatohen normalisht në gjykata, duhet të gjejnë zbatim edhe kur përdoret ODR, përveç rastit kur për shkak të specifikave që kanë mekanizmat ODR, lipset të veprohet ndryshe. Palët në procedurat që zhvillohen nëpërmjet ODR duhet të identifikohen nëpërmjet përdorimit të mekanizmave të sigurtë. Në vijim, po rendisim disa nga parimet bazë që duhet të ndiqen në dezanjimin dhe përdorimin nga gjykatat të ODR, të cilat së paku pjesërisht duhet të përfshihen në rregullat ligjore të procedurës civile.

- 1) Procedura e drejtë.
 - a. Qasja në drejtësi.

- i. ODR duhet të jetë e lehtë për tu kuptuar, e leverdishme dhe e thjeshtë në përdorim, në mënyrë që të mund të përdoret në mënyrë komode nga sa më shumë subjekte.
 - ii. Palët duhet të informohen për mënyrën si funksionon ODR, si ta përdorin atë, si ta mbikëqyrin ecurinë e procedurave dhe si të kenë qasje në vendimet e gjykatës.
 - iii. Përdorimi i ODR nuk duhet të jetë i pa favorshëm për palët apo t'i japë ndonjërrës prej tyre një avantazh të padrejtë.
 - iv. ODR duhet të dezanjohet dhe zbatohet në përputhje me standardet teknike të njohura ndërkombëtarisht, në mënyrë që të përdoret nga sa më shumë njerëz dhe me sa më shumë autonomi që të jetë e mundur.
 - v. Kostot e procedurave gjyqësore në të cilat përdoret ODR nuk duhet të jenë më të larta se ato të në të cilat nuk përdoret ODR.
 - vi. Palët duhet të njoftohen në rastet kur në gjykimin e çështjes së tyre, synohet të përdoren mekanizma të Inteligjencës Artificiale.
- b. Barazia e palëve
- i. Pjesëmarrja në procedurat që zhvillohen me ODR nuk duhet të cenohet të drejtën e individit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurat gjyqësore apo për të pasur një zgjidhje efektive të çështjes së tij.
 - ii. Procesi në të cilin përdoret ODR duhet të garantojë standardin e pavarësisë dhe paanësisë.
 - iii. Palët duhet të kenë dijeni për materialet e çështjes, përfshirë ato që janë dorëzuar nga palët e tjera, si dhe të kenë kohë të mjaftueshme për tu njohur me to.
- c. Provat e marra gjatë procedurave me ODR
- i. Ndershmëria e procedurës duhet të garantojë që aty ky përdoret ODR, palët duhet të kenë mundësi të paraqesin prova në një mënyrë të tillë që nuk i vë në pozitë më të dobët vis-a-vis palëve të tjera.
 - ii. Palët duhet të kenë mundësi të prezantojnë çështjen e tyre dhe të kundërshtojnë provat e paraqitura nga palët e tjera.
 - iii. ODR duhet të respektojë parimet e qartësisë (parashikueshmërisë) ligjore dhe mbrojtjen e pritshmërive legjitime të palëve.
- d. Procedura efektive
- i. Zbatimi i ODR duhet të synojë përmirësimin e efektivitetit të procedurës duke lejuar palët që të marrin pjesë në të pa qenë të pranishëm fizikisht në gjykatë dhe për sa është e mundur të transmetohet në kohë reale e gjithë procedura.

- ii. Vështirësitë teknike në funksionimin e ODR nuk duhet të pengojnë gjykatat, edhe për periudha të shkurtra kohore, që të shqyrtojnë çështjet dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm proceduralë.
 - iii. Nëse ligji vendor parashikon se zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve është një parakusht për iniciimin e procedurave gjyqësore, përfshirë edhe ato që kryhen me ODR, kjo nuk duhet të zgjasë në mënyrë të panevojshme procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, apo të shkaktojë një rritje substanciale të kostove të palëve.
- e. Dhënia e vendimit
- i. Aktet përfundimtare në një proces të kryer me ODR, duhet të jenë transparente.
 - ii. Çdo vendim përfundimtar i marrë nëpërmjet përdorimit të ODR duhet të bëhet publik në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.
- f. E drejta për një vendim gjyqësor të arsyetuar
- i. Arsye të mjaftueshme duhen dhënë në vendimet që merren nëpërmjet përdorimit të ODR apo me ndihmën e ODR, në veçanti vendimet e marra nëpërmjet përfshirjes së mekanizmave të Inteligjencës Artificiale (IA).
- g. Përmbartimi i vendimeve
- i. Fakti se një vendim është marrë duke përdorur mekanizma të ODR, nuk duhet të pengojë ekzekutimin e detyrueshëm të tij.
- h. E drejta e shqyrtimit gjyqësor të rasteve në të cilat zbatohen procedura të vendimmarrjeve automatike.
- i. Aty ku ligji vendor lejon marrjen e vendimeve nëpërmjet proceseve të përpunimit automatik, për këto vendime automatike duhet të jetë e mundur që ato të rishikohen nga një gjyqtar.
- 2) Transparenca në përdorimin e ODR dhe kërkesat për seancat
- a. Transparenca në dizajnimin (projektimin) dhe zbatimin e mekanizmave të ODR
- i. Projektimi (dizajnimi) dhe zbatimi i mekanizmave ODR duhet të jetë transparent dhe të shpjegohet në një mënyrë të kuptueshme nëpërmjet përdorimit të një gjuhe të qartë dhe të thjeshtë.
- b. Seancat publike dhe verbale
- i. Përdorimi i mekanizmave ODR duhet të garantojë mënyra të përshtatshme për të mundësuar mbikëqyrjen publike të procedurave.
 - ii. Përdorimi i ODR në gjykata nuk duhet në vetvete të përbëjë pengesë për palët që të kërkojnë një seancë verbale, të paktën në një nivel të juridiksionit gjyqësor.
- c. Çështje të tjera që lidhen me transparencën dhe mbikëqyrjen publike

- i. Palët e procesit në të cilin përdoret ODR duhet të informohen mbi çdo konflikt interesi që lidhet me përdorimin e mekanizmave të ODR.
 - ii. ODR duhet të projektohet në atë mënyrë që të gjithë dokumentet e prodhuara, përfshirë vendimin përfundimtar të gjykatës dhe vendimet apo njoftimet e tjera, të jenë të shkuara në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë.
 - iii. Rregullat procedurale që lidhen me përdorimin e ODR duhet të jenë transparente.
 - iv. Palët në procedurat ku përdoret ODR duhet të informohen dhe të kenë mundësinë të kenë qasje në rregullat procedurale që zbatohen për ODR.
- d. Çështje të veçanta në lidhje me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe teknikave ODR
- i. Siguria kibernetike
 - 1. Produktet e TIK, shërbimet apo proceset që lehtësojnë përdorimin e ODR duhet të jenë të sigurta, në mënyrë që të pajtohen me kërkesat e neneve 6 dhe 13 të KEDNj dhe të sigurojnë krijimin dhe ruajtjen e besimit dhe konfidencës në mekanizmat ODR.
 - 2. Nivelë i sigurisë kibernetike për produktet TIK, shërbimet dhe proceset që lehtësojnë përdorimin e ODR do të konsiderohet i përshtatshëm, kur janë ofruar garanci kundër:
 - a. Qasjes së paautorizuar në të dhënat konfidenciale.
 - b. Ndryshimi apo fshirja e padëshiruar e të dhënave.
 - c. Pamundësia teknike për të pasur qasje në sistem dhe në të dhënat e tjera që mban ai, për përdoruesit e ODR.
 - d. Pasigurisë në lidhje me identitetin e gjyqtarit apo profesionistëve të tjerë që përfshihen në procedurat nëpërmjet ODR
 - e. Mashtrimit me identitetin e palëve.
 - ii. Mbrojtja e të drejtave të njeriut, përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale
 - 1. Shtetet duhet të vlerësojnë ndikimin e përdorimit të ODR mbi individët dhe grupet sociale, gjatë gjithë jetëgjatësisë së tij, dhe të identifikojnë kërkesa specifike për përdorimin etik dhe të drejtë të ODR, me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut, si pjesë e pandarë e zhvillimit dhe përdorimit të çdo lloj mekanizmi ODR.
 - 2. Përdorimi i ODR nuk duhet të cenojë mbrojtjen e të dhënave, përfshirë, aty ku gjen zbatim, të drejtën e informimit, të drejtën e qasjes në të dhëna, të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave dhe të drejtën për fshirjen e të dhënave.

3. Duhet të implementohen masa teknike dhe organizative për të siguruar që të respektohen rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, si gjatë përcaktimit të mënyrave të procedimit ashtu edhe gjatë përpunimit të të dhënave.
4. Mekanizmat ODR duhet të projektohen dhe zhvillohen duke zbatuar parimet e mbrojtjes së të dhënave personale drejtpërdrejtë dhe në mënyrë strukturore, duke u kujdesur veçanërisht që
 - a. Zbatimi i masave teknike apo organizative që sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit, posaçërisht, të teknikave anonimizuese apo pseudoanonimizues.
 - b. Vendosja e kufizimeve në qasje apo ripërdorim të të dhënave nga autoriteti kompetent i cili i mban dhe kontrollon ato.
5. Marrja nga operatorë të jashtëm e shërbimeve ODR, nuk duhet të lejojë përpunimin e të dhënave personale për qëllime tregtare.

2.2. Parimet bazë për provat elektronike në proceset gjyqësore civile

Në epokën dixhitale, gjykatat ndeshen përherë e më shumë me të dhëna elektronike, të cilat përbëjnë prova për faktet e ndryshme me rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, tregtare, ekonomike apo administrative. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ka miratuar udhërrëfyesin CM(2018)169 “Mbi provat elektronike në proceset civile dhe administrative”, i cili përbën një mjet praktik për shtetet që të përshtatin veprimtarinë procedurale në drejtim të përdorimit gjithnjë e më të madh të provave elektronike. Natyrisht që legjislacioni i posaçëm për komunikimin elektronik apo dokumentet elektronike, është mjeti parësor për evidentimin e atyre të dhënave elektronike që mund të përbëjnë provë në gjykimet civile, porse edhe legjislacioni procedural nevojitet të ketë disa parime bazë në lidhje përkufizimin e provave elektronike, llojet e tyre, mënyrën e paraqitjes dhe administrimit të tyre në gjykim, si dhe fuqinë provuese të tyre. Sipas udhërrëfyesit me prova elektronike kuptohet çdo fakt provues që rrjedh nga të dhënat që mban apo prodhon çdo pajisje, funksionimi i të cilës varet nga një program elektronik (softëare) apo të dhëna që ruhen apo transmetohen me anën e një sistemi apo rrjeti të caktuar kompjuterik. Me rëndësi është edhe koncepti i “të dhënave meta” (metadata) i cili i referohet çdo informacioni elektronik në lidhje me të dhëna të tjera elektronike, të cilat mund të nxjerrin në pah të dhëna identifikuese, origjinën apo historikun e krijimit të provës, së bashku me datën apo kohën e krijimit apo ndryshimit të të dhënave. Në vijim, po parashtrojmë disa nga parimet themelore të elaboruara në rang European (Këshilli i Europës), sa i përket provave elektronike.

1. U takon gjykatave të vendosin në lidhje me fuqinë provuese të provave elektronike, në përputhje me legjislacionin vendas.
2. Provat elektronike duhet të çmohen në të njëjtën mënyrë si provat e tjera, veçanërisht sa i përket pranueshmërisë, autenticitetit, saktësisë dhe integritetit.
3. Trajtimi që i bëhet provave elektronike nuk duhet të jetë disavantazhues për palët apo t'i japë një përparësi të pamërituar ndonjëres prej tyre.
4. Provat verbale (dëshmitë) të marra me mjete të komunikimit në distancë.
 - a. Provat verbale mund të merren në distancë, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve të përshtatshme, nëse natyra e provës që kërkohet të merret e lejon këtë.
 - b. Për të vendosur nëse prova do të merret nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë, gjykata duhet të ketë parasysh se:
 - i. Rëndësinë e provës,
 - ii. Statusin e personit që jep dëshmi,
 - iii. Sigurinë dhe integritetin e lidhjes video nëpërmjet të cilës transmetohet prova,
 - iv. Kostot dhe vështirësitë për të sjellë dëshmitarin në gjykatë.
 - c. Gjatë marrjes së provës me mjete të komunikimit në distancë, duhet pasur kujdes që:
 - i. Transmetimi i dëshmisë orale të shihet dhe dëgjohej nga ata që janë të përfshirë në proces dhe nga publiku, nëse seanca është publike; dhe
 - ii. Personi që po dëshmon nga një vend i largët, është i aftë të shohë dhe dëgjojë procesin për aq sa është e nevojshme për të siguruar që procesi po zhvillohet në mënyrë të ndershme dhe efektive.
 - d. Procedura dhe teknologjia e përdorur për marrjen e provës në distancë nuk duhet të kompromentojë pranueshmërinë e kësaj prove dhe aftësinë e gjykatës për të verifikuar identitetin e personave të përfshirë.
 - e. Pavarësisht nëse prova transmetohet nëpërmjet një rrjeti privat apo publik, cilësia e videokonferencës duhet të garantohet dhe sinjali video të jetë i enkriptuar dhe i mbrojtur ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara.
5. Përdorimi i provave elektronike.
 - a. Gjykatat nuk duhet të refuzojnë provat elektronike dhe nuk duhet të mohojnë fuqinë ligjore të tyre, vetëm për faktin se ato janë mbledhur dhe/ose transmetuar në një formë elektronike.
 - b. Në parim, gjykatat nuk duhet të mos pranojnë fuqinë ligjore të provave elektronike vetëm për shkak se atyre u mungon një nënshkrim elektronik i avancuar apo i kualifikuar.
 - c. Gjykatat duhet të jenë të vetëdijshme për fuqinë provuese të metadata dhe pasojave të mundshme në mos përdorimin e tyre.

- d. Palët duhet të lejohen që të paraqesin prova elektronike në formatin e tyre origjinal, pa pasur nevojë për të paraqitur edhe printime të tyre.
6. Marrja forcërisht, mbledhja dhe transmetimi i provave elektronike
- a. Provat elektronike duhet të mbliidhen në një mënyrë të përshtatshme dhe të sigurtë, dhe ti dërgohen gjykatës nëpërmjet shërbimeve të besueshme.
 - b. Duke pasur parasysh rrezikun e lartë në shkatërrimin apo humbjen potenciale të provave elektronike, në raport me provat jo-elektronike, shtetet duhet të krijojnë procedura për marrjen forcërisht dhe mbledhjen e provave elektronike.
 - c. Gjykatat duhet të jenë të informuara në lidhje me çështjet specifike që mund të lindin gjatë marrjes forcërisht dhe mbledhjes së provave elektronike jashtë vendit, sidomos në çështjet ndërkufitare. Gjykatat duhet të bashkëpunojnë në marrjen ndërkufitare të provave elektronike. Gjykata të cilës i paraqitet një kërkesë duhet të informojë gjykatën kërkuese për të gjitha kushtet, përfshirë edhe kufizimet, mbi bazën e të cilave mund të merren provat elektronike nga gjykata e kërkuar.
 - d. Provat elektronike duhen mbledhur, strukturuar dhe menaxhuar në një mënyrë të tillë që të lehtësojë transmetimin e tyre në gjykata të tjera, veçanërisht në gjykatat rishikuese (apel, Gjykatë Supreme).
 - e. Transmetimi i provave elektronike nëpërmjet mjeteve elektronike duhet inkurajuar dhe lehtësuar në mënyrë që të rritet eficaenca e procedurave gjyqësore.
 - f. Sistemet dhe pajisjet që përdoren për transmetimin e të provave elektronike duhet të jenë të afta për të ruajtur integritetin e tyre.
7. Rëndësia
- a. Gjykatat duhet të përfshihen në menaxhimin aktiv të provave elektronike, me qëllim që veçanërisht, të shmangët paraqitja apo kërkimi i tepruar apo spekulativ i tyre.
 - b. Gjykatat mund të kërkojnë analizimin e provave elektronike nga ekspertë, veçanërisht në rast se ngrihen problematika komplekse në lidhje me provueshmërinë e tyre, apo kur pretendohet manipulimi i tyre. Gjykatat duhet të vlerësojnë vetë nëse këta ekspertë zotërojnë ekspertizën e mjaftueshme për të bërë verifikimet e kërkuara.
8. Besueshmëria
- a. Në lidhje me besueshmërinë, gjykatat duhet të marrin parasysh të gjithë faktorët në lidhje me burimin dhe autenticitetin e provës elektronike.
 - b. Gjykatat duhet të jenë të vetëdijshme në lidhje me vlerën e shërbimeve të kualifikuara në lidhje me besueshmërinë e provave elektronike.

- c. Për aq sa ligji vendas e lejon dhe bazuar në diskrecionin e gjykatës, të dhënat elektronike duhet të pranohen si provë në rast se autenticiteti i këtyre të dhënave nuk kundërshtohet nga një prej palëve.
 - d. Nëse ligji parashikon mbrojtje të veçantë për kategori të posaçme personash vulnerabël, duhet të gjejë zbatim rregullimi i posaçëm.
 - e. Për sa parashikon ligji vendas, nëse një autoritet publik transmeton prova elektronike në mënyrë të pavarur nga palët, këto prova mjaftojnë për të provuar përmbajtjen e tyre, përveç dhe derisa të provohet e kundërta.
9. Magazinimi dhe ruajtja
- a. Provat elektronike duhet të ruhen në një mënyrë që të ruajë lexueshmërinë, aksesibilitetin, integritetin, autenticitetin, besueshmërinë dhe, aty ku gjen zbatim, konfidencialitetin dhe privatësinë.
 - b. Provat elektronike duhet të ruhen me metadata të standardizuara në mënyrë që konteksti i krijimit të tyre të jetë i qartë.
 - c. Lexueshmëria dhe aksesibiliteti në provat elektronike të ruajtura duhet të garantohet në kohë, duke mbajtur parasysh edhe zhvillimin e teknologjisë së informacionit.

3. Problematikat e konstatuara nga zbatimi praktik i normave procedurale

Një nga nevojat më imediate që shkakton ndryshimin e një rregulli ligjor, rrjedh nga evidentimi i problematikave serioze në zbatimin praktik të tij. Burimi më i mirë për nxjerrjen në pah të problematikave të instituteve apo dispozitave të posaçme procedurale civile janë subjektet që merren me zbatimin e përditshëm të tyre, si dhe studimet profesionale të bëra në fushën përkatëse. Për nevojat e këtij koncept dokumenti u vlerësua e nevojshme që krahas evidentimit të problematikave nga vështrimi krahasues i legjislacionit procedural civil, si dhe nga ç'ka rezultuar nga raportet e ndryshme të organizatave ndërkombëtare për drejtësinë në Kosovë, si dhe koncept dokumenti i mëparshëm për ndryshimin e ligjit "Për procedurën kontestimore", të vilet edhe mendimi i gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjerë të së drejtës, në drejtim të identifikimit të problematikave me ligjet kryesore që përbëjnë korpusin ligjor që mendohet të përfshihet në Kodin e Procedurës Civile të Kosovës. Po ashtu, edhe grupi i punës, i përbërë nga profesionistë të ndryshëm të së drejtës evidentoi disa problematika konkrete në lëmin e procedurës civile. Në vijim do të trajtohen disa nga problematikat e evidentuara.

3.1. Problematika të evidentuara nga pyetësi drejtuar gjykatave.

Pyetësi që iu drejtua gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjerë të ligjit përmbajti 15 pyetje të natyrave të ndryshme. Në vijim po parashtrijmë pyetjet e shtruar dhe një përmbledhje të përgjigjeve të marra nga gjyqtarët, për secilën pyetje më vete.

- (1) A mendoni se është i nevojshëm Kodifikimi i ligjeve procedurale civile në Kosovë (miratimi i një Kodi të Procedurës Civile)?
Rezultati: Të gjithë të intervistuarit shprehën mendimin se miratimi i një Kodi të Procedurës Civile është mëse i domosdoshëm për Kosovën, pasi e bën më të lehtë qasjen në legjislacionin procedural.
- (2) Cilat mendoni se janë problematikat kryesore procedurale të cilat vështirësojnë procedurën e gjyimit pranë gjykatave të shkallës së parë?
Rezultati: Të intervistuarit identifikuan si fusha problematike në zbatimin e procedurës civile, afatet procedurale (qenia e tyre shumë të ngushtë), shtyrja e seancave, mos dërgimi me rregull i ftesave gjyqësore, pamundësia e dërgimit të tyre në rrugë elektronike, ndryshimi i shpeshtë i adresave të palëve, vonesat e lëndëve të ekspertët, ngarkesa në lëndë, sigurimi i prezencës së palëve në shqyrtime, plotësimi i formularëve dhe punëve të tjera tekniko-administrative, përfshirë edhe futjen e shkresave në SMIL, mos kompletimi i parashtrësive të dorëzuara në gjykatë në formën që parashihet në ligj (sidomos kur palët janë laik).
- (3) Cilat mendoni se janë problematikat kryesore procedurale të cilat vështirësojnë procedurën e gjyimit pranë gjykatës së Apelit?
Rezultati: Të intervistuarit renditën si problematikë afatet procedurale, numrin e madh të lëndëve, formimin e kolegjeve sipas sistemit SMIL, mungesa e stafit mbështetës, mos kompletimin e lëndës me fletëkthesa, siç janë fletëkthesa për pranimin e aktgjyimit, te procedura me ankesë, ku nuk është dorëzuar ankesa për përgjigje. Kjo passjell nevojën për vlerësimin e afatit të paraqitjes së ankesës. Po ashtu, vultat e pranimit të postës janë shpesh herë të padukshme, ç'ka vështirëson llogaritjen e afateve procedurale.
- (4) Cilat mendoni se janë problematikat kryesore procedurale të cilat vështirësojnë procedurën e gjyimit pranë Gjykatës Supreme?
Rezultati: Ndër problematikat e evidentuara nga të intervistuarit janë kryesisht afatet procedurale.
- (5) A mendoni se duhet një legjislacion procedural më i thjeshtuar për gjykimin e padive për mosmarrëveshje kontraktore me vlera të vogla (p.sh: nën 3000 euro)?
Rezultati: Të intervistuarit evidentuan faktin se një reformë e tillë është e nevojshme për të reduktuar numrin e çështjeve gjyqësore, pasi numri i lëndëve nën vlerën 3000 Euro është i lartë.
- (6) A mendoni se duhet të jetë i detyrueshëm përfaqësimi me avokat i palëve në të gjitha procedurat gjyqësore kontestimore dhe jokontestimore?

Rezultati: Në lidhje me këtë pyetje të intervistuarit shprehen në mënyrë të ndryshme, ku një pjesë nuk është dakord me përfaqësimin e detyrueshëm me avokat, një pjesë tjetër është dakord por me kusht që të vendoset përjashtim për kategori të caktuara të subjekteve, disa të tjerë shprehen se do të ishte e nevojshme që të vendosej përfaqësimi i detyrueshëm për disa kategori çështjes, si p.sh: marrëdhëniet e punës apo çështjet e trashëgimisë, apo kontestet me vlerë mbi 10.000 euro.

- (7) A mendoni se duhet të përfshihen edhe procedurat gjyqësore të falimentimit si një nga llojet e gjykimeve të posaçme në Kodin e Procedurës Civile?

Rezultati: Shumica e të intervistuarve shprehen në favor të përfshirjes në Kodin e Procedurës Civile të rregullave të detajuara për gjykimin e procedurave të falimentimit.

- (8) A mendoni se aktualisht ka problematika në procesin gjyqësor civil, sa i përket procedurës së njoftimit të palëve? Nëse po a mund të identifikoni disa prej tyre?

Rezultati: Sipas shumicës së të intervistuarve, problematikat me sistemin e adresave në Kosovë, ndërrimi i emrave të rrugëve, mosnjoftimi i gjykatës nga palët për ndërrimin e adresës, përbëjnë problematika që zvarrisin gjykimin.

- (9) A po përballet gjykata juaj me mbingarkesë (backlog) në gjykimin e çështjeve? Nëse po, cilat mendoni se janë shkaqet e krijimit të tij?

Rezultati: Sipas të intervistuarve, mungesa e gjyqtarëve dhe stafit mbështetës, territori i gjerë i kompetencave të gjykatave, numri i lartë i popullsisë në territorin e gjykatës, taksat e ulta gjyqësore, numri i lartë i çështjeve të ankimuara, numri i lartë i çështjeve me natyrë urgjente, kanë passjellë ngarkesë dhe vonesa në gjykimin e çështjeve.

- (10) A mendoni që është i nevojshëm rregullimi ligjor konkret i mundësisë së zhvillimit të seancave gjyqësore përmes mjeteve të komunikimit elektronik?

Rezultati: Shumica e të intervistuarve shprehen se është një rregullim ligjor i gjykimin në distancë është i nevojshëm. Veçse shprehet shqetësimi që ky rregullim duhet të jetë i tillë që t'i përshtatet zhvillimit teknologjik në kohët e sotme. Mekanizmat që do të adoptohen, duhen testuar mirë më parë.

- (11) A mendoni që duhet të krijohet një mekanizëm procedural për shmangien e zvarritjeve dhe rritjen e efikasitetit të gjykimin brenda një afati të arsyeshëm të çështjeve gjyqësore?

Rezultati: Shumica e të intervistuarve shprehen në favor të krijimit të një mekanizmit të tillë procedural. Disa të intervistuar kërkojnë që të eliminohen procedurat e panevojshme që nuk kanë efekt dhe të shkohet me zgjidhje të metodave sa më pragmatike.

- (12) A mendoni se aktualisht gjykata ka kompetenca të mjaftueshme ligjore për të parandaluar dhe ndëshkuar abuzimin nga palët ose përfaqësuesit e tyre me të drejtat gjatë procesit?

Rezultati: Shumica e të intervistuarve shprehen se rregullat ekzistojnë, por ka vend për zbatimin më të mirë të tyre. Ndërsa ka edhe nga ata të intervistuar që mendojnë se rregullat aktuale duhen përmirësuar edhe më tej.

- (13) A mund të identifikoni ndonjë problem procedural në procedurat gjyqësore jokontestimore në Kosovë?

Rezultati: Shumica e të intervistuarve nuk identifikuan ndonjë problematikë në lidhje me procedurat jokontestimore. Megjithatë një pjesë e të intervistuarve mendojnë se ka vend për përmirësim sa i përket procedurave të shpronësimit. Po një i intervistuar identifikoi si problem zbatimin e ligjit në kohë, kur një çështje është gjykuar para vitit 1999 sipas procedurës jokontestimore dhe më pas paraqitet padi kontestimore për kompensim shtesë dhe ngrihet problematika e gjësë së gjykuar.

- (14) A mund të identifikoni ndonjë problem procedural që ka nevojë për rregullim në procedurat përmbarimore?

Rezultati: Shumica e të intervistuarve nuk identifikuan ndonjë problematikë në lidhje me procedurat përmbarimore. Disa prej tyre evidentuan si problematika kuptimin e dokumentit përmbarimor (përshtatshmëria e tij dhe vdekja e debitorit dhe ushtrimi i prapësimit nga trashëgimtarët e tij). Po ashtu, për përmbarimet private gjykatat të vendosin si organ i shkallës së dytë (sipas ankesave), ndërsa për prapësimet të vendosin përmbaruesit, ose prapësimi të konsiderohet padi dhe çështja të ndiqet sipas procedurës kontestimore.

- (15) A keni ndeshur në praktikë ndonjë problematikë tjetër procedurale që do të donit të rregullohej nëpërmjet miratimit të Kodit të Procedurës Civile të Kosovës?

Rezultati: Shumica e të intervistuarve nuk evidentuan ndonjë problematikë shtesë. Një i intervistuar parashtroi se ka problematikë që duhet adresuar sa i përket çështjeve pronësore dhe fitimit të pronësisë me parashkrim fitues në pronën publike, shoqërore dhe private me kalimin e afatit 20 vjeçar.

3.2. Disa nga problematikat e evidentuara më herët nga koncepti i dokumentit i hartuar në 2018 për ndryshimin e ligjit "Për procedurën kontestimore" janë:

- a. Përcaktimi i më qartë i lëndëve që gjykohen sipas secilës gjykatë. Pra përcaktim më i saktë i kompetencës lëndore.
- b. Problematikat më dërgimin e njoftimeve (thirrjeve) pasi ligji nuk e detyron paditësin që të përcaktojë dhe identifikojë qartë adresën e të paditurit.

- c. Rregullim më i mirë e më cilësor i përfaqësimit gjyqësor.
- d. Përcaktim më i qartë i afateve procedurale brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi në secilën shkallë.
- e. Në funksion të gjykimit të shpejtë e pa vonesë duhet të përcaktohen qartë se cilat janë rastet kur Gjykata e Apelit prish vendimin e shkallës së parë dhe e kthen për rigjykim (Shfuqizon vendimin).
- f. Rregullimi i shkaqeve të rekursit.
- g. Rregullimi më i mirë i padive me vlerë të vogël.
- h. Zgjidhja e disa çështjeve në rrugë jashtë gjyqësore si për shembull për çështjet e pakontestuar të trashëgimisë të cilat mund të zgjidhen pranë noterit, etj.¹⁶

3.3. Problematika të evidentuara nga vështrimi krahasues i legjislacionit procedural të Kosovës dhe analiza e grupit të punës për hartimin e KD:

- 1) Vihet re se procedura në kontestet (mosmarrëveshjet) me vlerë të vogël, nuk është e harmonizuar plotësisht me Rregulloren nr. 861/2007 të Parlamentit European dhe të Këshillit "Për krijimin e Procedurës Europiane për Mosmarrëveshjet me Vlerë të Vogël". Vlera e mosmarrëveshjeve që gjykohen sipas neneve 484-491 të ligjit "Për Procedurën Kontestimore" është shumë e ulët, në raport me Rregulloren (mund të rritet në shumën 3000 Euro). Sipas nenit 5 të Rregullores rregulli në këto gjykime është që ato zhvillohen në formë shkresore dhe vetëm përjashtimisht lihet seancë. E gjithë procedura shkresore realizohet në bazë të formularëve që i janë bashkëlidhur Rregullores dhe që mund adaptohen dhe të përbëjnë aneks të legjislacionit procedural të Kosovës, apo të ngarkohet një organ i caktuar (Gjykata Supreme, ose Këshilli Gjyqësor i Kosovës), për miratimin e formatit të formularëve dhe bërjen publik të tyre për palët. Në frymën e Rregullores, ligji vendor duhet të saktësojë afatet për veprimet procedurale të gjykatës dhe të palëve në çështje të kësaj natyre. Në zbatim të neneve 8 dhe 9 të Rregullores duhet të parashikohen procedura të thjeshtuara për dëgjimin e palëve nëpërmjet mjeteve teknologjike të komunikimit në distancë (videokonferencë) dhe për marrjen e provave (nëpërmjet dëshmitëve të shkruara). Aktgjykimi në çështjet me vlerë të vogël u njoftohet pa arsyetim palëve dhe vetëm nëse ato kërkojnë të paraqesin ankim në gjykatën më të lartë, duhet ta njoftojnë gjykatën dhe kjo e fundit të arsyetojë vendimin e t'ua vërë në dispozicion, brenda afateve të mirëpërcaktuara. Duhet pranuar rishikimi i vendimit në rastet e përcaktuara në nenin 18 të Rregullores.
- 2) Në implementim të nenit 6 të Rekomandimit nr. R(95)5, datë 07.02.1995 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, me qëllim rritjen e shpejtësisë dhe efektivitetit të gjykimit në gjykatat rishikuese, duhet parashikuar mundësia që disa lloj çështjes me natyrë procedurale (paraqitja e ankimit apo kërkesës procedurale jashtë afatit, apo një

¹⁶ Koncept Dokumenti për Procedurën Kontestimore, miratuar me vendimin Nr. 09/77, datë 4.12.2018.

ankim i paplotë që nuk është ndrequr, etj) apo për ankimet ndaj vendimeve të dhëna në mosmarrëveshjet (kontestet) me vlerë të vogël, ankesa në Gjykatën e Apelit apo revizioni në Gjykatën Supreme të shqyrtohet me një gjyqtar të vetëm në vend të gjykimit me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

- 3) Procedura e dhënies së urdhërpagesës sipas neneve 492-504 të ligjit "Për Procedurën Kontestimore", duhet harmonizuar me Rregulloren nr.1896/2006 të Parlamentit European dhe të Këshillit "Për Krijimin e Procedurës për Urdhërpagesën Europiane". Duhet veçuar procedura gjyqësore për lëshimin e urdhërpagesës me atë që lind kur i padituri sjell prapësim për bazueshmërinë në prova apo në ligj të kërkesës së paditësit për lëshimin e urdhër pagesës. Procedura për lëshimin e urdhërpagesës duhet të jetë një procedurë formale, në të cilën gjykata nuk shikon meritat (themelin) e pretendimeve, por vetëm plotësimin e kriterëve formale për lëshimin e urdhërpagesës. E gjithë procedura për lëshimin e urdhërpagesës duhet të jetë shkresore dhe sa më automatike dhe të realizohet në bazë të formularëve që i janë bashkëlidhur Rregullores të cilët mund adaptohen dhe të përbëjnë aneks të legjislacionit procedural të Kosovës, apo të ngarkohet një organ i caktuar (Gjykata Supreme, ose Këshilli Gjyqësor i Kosovës), për miratimin e formatit të formularëve dhe bërjen publik të tyre për palët. Afatet aktuale janë shumë të ngushta, e duhet të përshtaten me ato të Rregullores. Mund të caktohet Gjykata Themelore e Prishtinës, si gjykata kompetente për procedimin e të gjitha kërkesave për lëshim urdhërpagese në Kosovë.
- 4) Duhet miratuar një mekanizëm efektiv ligjor për të adresuar shqetësimet e palëve për zvarritje të procedurave gjyqësore apo përmbarimore, duke iu dhënë mundësi atyre që të kërkojnë konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin apo përmbarimin e çështjeve (lëndëve) dhe marrjen e masave përkatëse për përsheptimin e gjykimit apo përmbarimit. Vetëm nëse këto masa dështojnë, atëherë mund të shkohet tek shpërblimi monetar i dëmit në vlera të paracaktuara, për vonesën që është shkaktuar në gjykimin apo përmbarimin e çështjes. Standardet e CEPEJ dhe jurisprudenca e GjEDNj¹⁷ janë udhërrëfyes për krijimin e këtij mekanizmi që synon zbatimin efektiv të neneve 6 dhe 13 të KEDNj. Si model mund të merren dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë (nenet 399/1-399/12), të cilat e kanë kaluar testin e përputhshmërisë me nenin 6 të KEDNj, siç është konfirmuar nga jurisprudenca e GjEDNj.
- 5) Nevojitet një parashikim dhe përmirësim i dispozitave aktuale në lidhje me mundësinë e gjykatave për të zhvilluar gjykime në distancë dhe në lidhje me administrimin e provave elektronike. Për këtë mund të shërbejnë standardet Europiane të elaboruara më herët në këtë Koncept Dokument.

¹⁷ Çështja Bara dhe Kola k. Shqipërisë (Kërkesat nr. 43391/18 dhe 17766/19), vendim i GjEDNj i datës 12.10.2021, bërë përfundimtar më datë 28.02.2022.

- 6) Nevojitet një përmirësim gjuhësor i dispozitave procedurale, për ti bërë ato më të qarta e më të lehta në përdorim jo vetëm për profesionistët e së drejtës, por edhe për personat që nuk janë juristë. Procesi i kodifikimit do të ishte një mundësi e mirë për një ndërhyrje kapilare në dispozitat e ndryshme procedurale, për harmonizimin dhe korrektimin e terminologjisë juridike të përdorur.
- 7) Në takimet e grupit të punës është evidentuar se struktura e LPK-së është jofunksionale dhe duhet të rishikohet në kuptim të renditjes së dispozitave dhe instituteve procedurale civile. Neni 18 i LPK-së paraqet vështirësi në zbatim. Duhet të shihet mundësia e plotësimit të nenit 99 të LPK (p.sh: në drejtim të komunikimit elektronik, si dhe bashkëlidhjes së autorizimit (prokurës) në rastet kur padia paraqitet nga përfaqësuesi), pasi nuk ka parashikim për rrëzimin e padisë (hedhjen poshtë) si e palejuar për shkak se është paraqitur nga personi i paautorizuar, siç është e rregulluar te mjetet e goditjes.
- 8) Parashitërat që i drejtohen gjykatës duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë disa elementë të domosdoshëm (emrin e gjykatës, gjeneralitetet e palëve, objektin e mosmarrëveshjes, përmbajtjen e parashitës, nënshkrimin, etj). Në lidhje me nenin 102 të LPK të rishikohet mundësia e plotësimit të udhëzimit për përfaqësues të përkohshëm (në lidhje me nenin 81).
- 9) Nevojitet që sipas nenit 104 të LPK, të rishikohet mundësia e dërgimit të shkresave përmes postes elektronike. Në lidhje me nenin 133 të LPK nevojitet të rishikohet dhe të qartësohet sa i përket mjetit të goditjes kundër vendimit për kthim në gjendje të mëparshme sepse në praktikë ka dilema se kur lejohet mjete i goditjes e në veçanti të sqarohet se a lejohet kur shqyrtimi mbahet në mungesë të palës së ftuar në mënyrë të rregullt apo vetëm në rastet kur gjykata merr aktgjykim për shkak të mungesës në kuptim të nenit 151.
- 10) Referuar nenit 151 të LPK aktgjykimi për shkak të mungesës, duhet të shikohet nevoja e ekzistencës së tij, për arsye se me këtë nen është paraparë mundësia që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mungesës mirëpo, një mënyrë e vendosjes sipas dispozitave të LPK-së është pothuajse e pazbatueshme e duke marrë parasysh se në bazë të nenit 394 për përgjigje në padi është obligim të padia ti dërgohet në përgjigje.
- 11) Referuar nenit 162 (aktgjykimi plotësues), nevojitet të rishikohet për arsye se nga praktika kemi raste kur palët paraqesin kërkesa për plotësimin e aktgjykimit në rastet kur gjykata e shkallës së dytë nuk ka vendosur për të gjitha kërkesat e palëve si pika të veçanta të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë i cili është aktkuar me ankesë e të cilat kërkesa nuk janë paraqitur në afatin ligjor prej 15 ditësh.
- 12) Në lidhje me nenin 211 të LPK (Revizioni) nevojitet të shihet mundësia që të rritet vlera e kontestit.
- 13) Duhet të vlerësohet nevoja për saktësim të nenit 179 të LPK. Kjo dispozitë paraqet problematikë në rastet kur avokatët e licencuar paraqesin mjete të rregullta dhe të

jashtëzakonshme juridike në cilësi të të autorizuarve të palëve e të cilët mjetit të goditjes nuk ja ka bashkangjitur edhe autorizimin.

- 14) Neni 235 nevojitet të rishikohet dhe t'i shtohet edhe një paragraf sipas të cilit në rastet kur kërkohet përsëritja e procedurës kundër vendimeve të Gjykatës Supreme me të cilin vendim është ndryshuar vendimi i gjykatave të instancave me të ulëta, kompetente për të vendosur të jetë Gjykata Supreme.
- 15) Neni 245 (kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë) duhet të rishikohet në drejtim të vlerësimit se a është e nevojshme akoma të ekzistojë si mjet i jashtëzakonshëm juridik dhe nëse po, të përcaktohen saktë shkaqet për të cilat lejohet si dhe procedura që duhet zhvilluar.
- 16) Neni 253 (Përmbajtja e padisë) i LPK nevojitet të qartësohet edhe më tepër. Ndërsa në lidhje me nenin 297, të plotësohet paragrafi i dytë ashtu që afati ligjor të shtohet në tekst në lidhje me afatin 7 ditor. Ndërsa, duhet të vlerësohet mundësia që të shtohet edhe paragrafi sa i përket lartësisë së garancisë ashtu që për vlerën e kontestit deri në 10.000 euro lartësia e garancisë duhet të jetë deri në 3.000 euro, ndërsa, kur vlera e objektit të kontestit është në shumën mbi 10.000 euro lartësia e garancisë duhet të jetë 10% e vlerës së objektit të kontestit. Në vijim, sipas nenit 308, duhet të rishikohen dispozitat që lidhen me masat e sigurisë e në veçanti mjetet e goditjes që i referohen propozimeve për masa të përkohshme në rastet kur gjykatat vendosin jashtë seancës e me të cilat vendime refuzohet propozimi për caktimin e masave të tilla. Të parashihet që lënda të trajtohet me prioritet kur caktohet masa e sigurisë. Nevojitet të rishikohet edhe neni 308 i LPK-së.
- 17) Në lidhje me nenin 356 (Ekspertet) të LPK-se, nevojitet të rishikohet kjo dispozitë e ndryshuar me nenin 21 të Ligjit për Ndryshime të LPK-së, për arsye se në praktikë janë paraqitur dilema se gjykata a duhet gjithmonë që sipas detyrës zyrtare të marrë prova me ekspertim apo vetëm në rastet përjashtimore siç parashihet në nenin 7 paragrafi 2 të LPK-se, për çështjet statusore si dhe në rastet e parapara me ligj.
- 18) Në lidhje me nenin 392 pika a) të LPK-së, të shtohet teksti si në nenin 22 paragrafi 3 të LPK-së. Në nenin 485 paragrafi 1 - Vlera e kontestit të jetë 3000 euro. Të shikohet mundësia e referimit në ndërmjetësim të detyrueshëm paraprakisht. Të konsiderohet mundësia që tek këto raste vendimi të ketë përmbajtje më të thjeshtësuar (arsyetimi vetëm sipas kërkesë). Në nenin 491 paragrafi 1 të LPK-së, të shtohet paragrafi: Aktgjykimi ose aktvendimi me të cilin përfundohet procedura e zgjidhjes së kontestit me vlerë të vogël nuk duhet të ketë arsyetim, përjashtim rasteve kur palët kërkojnë, dhe nëse kërkojnë arsyetim do të paguajnë takse shtese (sipas vlerës se percaktuar).
- 19) Paraqitet e nevojshme të shikohet Ligji për Gjykatën Komerciale dhe Kreu XXX i LPK-së të fshihet nga LPK ose mos të përfshihet në Kodin e Procedurës Civile. Njëjtë të veprohet dhe me Kreun XXIX që rregullon Procedurën për Urdhërpagesë. Nevojiten të saktësohen edhe dimensionet e rolit aktiv të Gjykatës (Neni 7.2, 319 I LPK).

- 20) Sa i përket Ligjit për Procedurën Jokontestimore, nevojitet të rishikohen dispozitat e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme me të cilat rregullohet kompensimi i pronës së shpronësuar, pjesët aksesore dhe frutat e saj, në mënyrë që të caktohet saktë kompetenca lëndore e gjykatës për të shqyrtuar të gjitha kërkesat e pronarit apo zotëruesit faktik, qoftë për pronën, pjesët aksesore dhe frutat e saj, që janë përfshirë me vendim përfundimtar për shpronësim, qoftë të atyre që nuk janë përfshirë me shpronësim.
- 21) Në procedurë jokontestimore të zbatohet përshtatshmërisht për situatat e njëjta neni 21 i LPK-së.
- 22) Nevojitet që normat procedurale civile të harmonizohen me rregullimet e të drejtës materiale që përmbahen në ligjet e ndryshme, si ligji për Familjen, ligji për Konfliktin Administrativ, ligji për Gjykatën Komerciale, ligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private, etj (përfshirë edhe Kodin e ardhshëm Civil).

Kapitulli 2: Objektivat

Ministria e Drejtësisë në kuadër të Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025, ka paraparë "Reformimin e sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative." Në këtë drejtim, në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor, qëllimi strategjik 9.1. Drejtësi efektive.

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Objektivi relevant	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Qëllimi strategjik – Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 Plani Kombëtar për Zhvillim
Objektiva specifike – Reformimi i legjislacionit të fushës procedural civile conform ndryshimeve edhe të fushave tjera materiale të drejtës civile	Sipas këtij Koncept Dokumenti.
Qëllimi i politikës – Realizim i qasjes në drejtësi Brenda afatit të arsyeshëm kohor.	Sipas këtij Koncept Dokumenti.

Kapitulli 3: Opsionet

Vlen të theksohet paraprakisht se ndër vendet e rajonit, me përjashtim të shteteve ish anëtare të ish Jugosllavisë, legjislacioni procedural civil gjendet i normuar në Kodet respektive të Procedurës Civile. P.sh: Shqipëria, Greqia, Bullgaria, etj.

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë është miratuar në vitin 1996 dhe ka marrë si model rregullimet e bëra nga Kodet e mëparshme të Procedurës Civile (para viteve 90), si dhe ka pasur një influencë të theksuar nga Kodi i Procedurës Civile të Italisë. Kodi ndahet në katër pjesë, ku pjesa e parë është me dispozita të përgjithshme, pjesa e dytë trajton gjykimin në shkallë të parë, pjesa e tretë trajton ankimet dhe mënyrat e gjyimit të tyre, ndërsa pjesa e katërt rregullon fazën përmbartimore, ose siç quhet ndryshe fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Kodi i Procedurës Civile të Shqipërisë bën rregullimin e procedurave me palë kundërshtare (kontestimore) dhe pa palë kundërshtare (jokontestimore), ashtu edhe procedurat përmbartimore. Kodi përcakton parimet kryesore të çdo lloji procedure gjyqësore, përbërjen, kompetencat dhe juridiksionin gjyqësor, rolin e gjykatës dhe palëve në menaxhimin e çështjes, përgjegjësinë e palëve për abuzim me të drejtat që rrjedhin nga procesi, mënyrën e paraqitjes së padisë, afatet, njoftimet, pavlefshmëritë, fazën paraprake dhe përgatitore, si dhe fazën e gjyimit dhe dhënies së vendimit. Kodi rregullon llojet dhe mënyrën e marrjes së provave. Po ashtu në Kod gjejnë parashikim edhe gjykimet e posaçme (jo kontestimore) apo procedura të veçanta (gjykimi i padive me vlerë të vogël). Kodi ka pësuar ndër vite 14 ndryshime, nëpërmjet të cilave janë përmirësuar dispozita të caktuara, si dhe janë përfshirë apo hequr rregulla të caktuara procedurale.

Greqia ka gjithashtu një Kod të Procedurës Civile (*Kodikas Politikis Dikonomias*) që rregullon procedurën para gjykatave civile. Ky Kod është miratuar në vitin 1968 dhe mbështetet shumë në parimin e iniciativës së palëve. Kodi rregullon kompetencat e gjykatave të shkallës së parë (me dy nivele), gjykatave të apeli dhe Gjykatës Supreme (Areios Pagos), e cila nuk ka tiparet e një gjykate apeli, por të një gjykate kasacioni. Kodi normon rregullat për paraqitjen e padisë në gjykatë, veprimet, afatet dhe detyrimet që kanë palët dhe gjykata në kuadër të gjyimit të çështjes. Po ashtu përcaktohen rregulla të detajuara për njoftimet, aktet e gjykatës, provat që mund të merren në gjykim, rregullat për paraqitjen e tyre, si dhe vendimmarrjen e gjykatës, si dhe mjetet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të ankimit. Kodi trajton edhe fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

Bullgaria ka miratuar në vitin 2008 Kodin e Procedurës Civile. Ky Kod përmban pjesën e parë me rregullat e përgjithshme, të cilat përmbajnë parimet bazë të procedurës civile (ligjshmëria, parimi i disponimit, parimi i veprimtarisë ex-officio të gjykatës, parimi i kontradiktoritetit, barazisë së palëve, zbulimit të së vërtetës, etj). Kodi rregullon juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve civile, si dhe përbërjen e trupit gjykues në shkallë të parë, në apel dhe në kasacion. Po ashtu Kodi përmban dispozita për palët, zotësinë e tyre, përfaqësimin procedural, etj. Më tej parashikohen rregulla të posaçme për njoftimet, afatet dhe rivendosjen e tyre, etj. Kodi përmban edhe dispozita për ndihmën ligjore falas. Pjesa e dytë e Kodit, rregullon gjykimin në shkallë të parë, provat [përfshirë norma për paraqitjen e provave elektronike (neni 184)], ndryshimet që mund të ndodhin në lidhje me padinë, palët apo procesin. Në vijim Kodi rregullon mjetet e ankimit (apeli, apeli kasacional). Më tej Kodi trajton efektet e vendimeve të formës së prerë, si dhe revokimin e vendimeve. Pjesa e tretë e Kodit

trajton gjykimet e posaçme (zgjidhja e martesës, statusi civil i individëve, heqja e zotësisë për të vepruar, pjesëtimi i pasurisë trashëgimore, etj). Pjesa e katërt e Kodit trajton mjetet për sigurimin e padisë dhe masat e tjera të përkohshme që mund të marrë gjykata. Pjesa e pestë trajton procesin përmbarrimor (titulli ekzekutiv, urdhri i ekzekutimit, si dhe procedurat e veçanta përmbarrimore, etj). Pjesa e gjashtë parashikon rregulla të posaçme për masa të veçanta mbrojtëse (vërtetimi gjyqësor i faktit, shpallja e vdekjes, etj). Pjesa e shtatë parashikon rregulla që lidhen me procedura gjyqësore që preken nga rregullat e të drejtës së Bashkimit European (urdhër pagesa europiane, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja, etj).

Ndër vendet e ballkanit që bëjnë pjesë në Bashkimin European, por që nuk kanë një Kod të Procedurës Civile, mund të përmendim Kroacinë. Kjo e fundit në traditën e ish Jugosllavisë ka ligjin për Procedurën Civile, i cili përmban rregulla për gjykimet kontestimore. Pjesa e parë e këtij ligji përmban dispozitat e përgjithshme, rregullat për juridiksionin dhe kompetencën, palët dhe përfaqësuesit e tyre, gjuha e procesit, njoftimet, afatet, seancat, procesverbali, si dhe marrja e vendimit. Po ashtu në ligj janë parashikuar rregulla për bashkëpunimin gjyqësor. Ligji rregullon paraqitjen e padisë, kundërpadisë, bashkëndërgjyqësinë, pjesëmarrjen e personave të tretë, etj. Ligji përcakton llojet e provave dhe procedurën e marrjes apo sigurimit të tyre. Veprimet përgatitore të gjykatës dhe rregullat për gjykimin e çështjes, janë trajtuar në mënyrë të detajuar në nenet 277-347 të këtij ligji. Titulli i njëzet e pestë trajton mjetet e zakonshme të ankimit (apeli, ankimet e veçanta), ndërsa titulli i njëzet e gjashtë trajton mjetet e jashtëzakonshme të ankimit (revizionin, rishikimin). Pjesa e tretë e ligjit trajton disa nga gjykimet e posaçme kontestimore, si ato që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, cenimi i pronësisë, urdhër pagesat, etj. Ky ligj, ashtu siç është rasti edhe aktualisht në legjislacionin Kosovar, nuk përmban rregulla për procesin përmbarrimor, i cili rregullohet me ligj të veçantë.

Referuar ekspozesë së mësipërme, struktura e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, mund të shërbejë si një model i mirë për tu ndjekur nga Republika e Kosovës, i cili mund të mbahet parasysh *mutatis mutandis*, së bashku me parashikimet e ligjeve specifike procedurale civile të Kosovës, të cilat mund të shkrihen në një akt të vetëm (së bashku me ndryshimet përkatëse) dhe të përbëjnë Kodin e Procedurës Civile të Kosovës. Në këtë mënyrë, realizohet kodifikimi dhe konsolidimi i njëkohshëm i legjislacionit procedural civil. Për më tepër në vijim trajtohen opsionet e mundshme në lidhje me nismën për Kodifikim të legjislacionit procedural civil të Kosovës.

Opsionet e mundshme për të gjetur zbatim në rastin e rregullave procedurale civile, janë tre:

- 1) Të mos bëhet asnjë ndryshim,
- 2) Të ndryshohen ligjet e veçanta procedurale pa realizuar kodifikimin e të gjitha normave në një akt të vetëm dhe
- 3) Hartimi i një Kodi të Procedurës Civile të Kosovës, i cili do të mund të përmbledhë të gjitha dispozitat aktuale që normojnë procedurën civile, duke i harmonizuar ato me njëra-tjetrën dhe ndrequr problematikat që mund të jenë ndeshur në praktikë, duke pasur si busull gjithnjë standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e procedurës civile. Në vijim në krerët 3.1, 3.2 dhe 3.3 do të analizohet më vete secila nga tre alternativat e mësipërme.

Kapitulli 3.1: Asnjë ndryshim (Ruajtja e Status Quo-së)

Mos reformimi i rregullave procedurale civile, lë të paprekura të gjitha problemet e evidentuara në zbatimin e këtyre normave në praktikë. Në kushtet e nevojës së përsëritur për të ndryshuar përmbajtjen e dispozitave procedurale një problematikë kjo e vënë në dukje, midis të tjerash, edhe nga progres raportet e Bashkimit European, mosndërhyrja ligjore nuk është një variant që gëzon mbështetje. Problematikat e vëna në dukje edhe nga përpjekjet e mëhershme për të ndryshuar ligjin "Për procedurën kontestimore", dëshmojnë që nevoja për përmirësim të kuadrit ligjor procedural vjen edhe së brendshmi, për shkak të nevojës për të zgjidhur probleme me të cilat ata ndeshen në zbatimin praktik.

Për këtë arsye, ndonëse një variant i mundshëm, mosndërhyrja legislative dhe ruajtja e status quo-së nuk është një opsjon që mbështetet ndonëse nuk shoqërohet me kosto shtesë. Për këtë arsye, analiza e këtij varianti përfundon këtu e nuk shihet me vend vlerësimi i avantazheve, disavantazheve dhe sfidat, një metodologji e cila do të ndiqet në vijim për opsionet e tjera.

Kapitulli 3.2: Përmirësimi i ligjeve të veçanta procedurale civile pa kodifikim

Opsion tjetër i mundshëm është ndërhyrja veçmas në të gjitha ligjet që rregullojnë aspekte të procedurës civile, po pa i kodifikuar në një kod. Ky opsjon, mban parasysh nevojat për rishikim të normave procedurale të cilat janë vënë në pah më herët, por, ndonëse i mundshëm, kërkon miratimin e disa ligjeve ndryshuese të cilat duhet të adresojnë të gjitha problematikat e evidentuara në ligjet ekzistuese. Në terma të tjerë, kjo do të thotë, miratimin e të paktën katër ligjeve të tjera që të ndryshojnë e përmirësojnë ligjin nr. 03/L-006 "Për procedurën kontestimore" (i ndryshuar), ligjin nr. 03/L-007 "Për Procedurën Jokontestimore" (i ndryshuar), ligjin nr. 04/L-139 "Për Procedurën Përmbartimore" (i ndryshuar) dhe ligjin nr. 2004/26 "Ligji mbi Trashëgiminë e Kosovës" (për nenet 76-80 të tij).

3.2.1. Avantazhet

Ky variant ka avantazhin pasi kërkon më pak investim intelektual sepse nuk do të ketë nevojë për koordinim të imët të normave ekzistuese procedurale civile. Njëherësh ky opsjon do të reflektojë ndryshimet e nevojshme për të korrigjuar problematikat e konstatuara nga praktikuesit e së drejtës.

3.2.2. Disavantazhet

Nga ana tjetër, kjo mënyrë shkon në dëm të publicitetit efektiv të normave ligjore, pasi nuk ofron shumë siguri dhe qartësi juridike sepse rregullimi i aspekteve procedurale nga disa ligje

të ndryshme mbetet sfidë për juristët e aq më shumë për individët jo juristë që mbrojnë gjyqësisht çështjet e tyre. Ndaj, në këtë aspekt, shpërndarja e normave që kanë lidhje organike mes tyre në disa ligje njëherësh, nuk është një variant i mbështetur. Janë të pakta shtetet në Europë që vijojnë të kenë ligje të shpërndara në lëndën e procedurës civile. Shumica dërrmuese e tyre kanë Kode të Procedurës Civile, në të cilat janë përmbledhur normat bazë për rregullimin e procesit gjyqësor civil që në fazat e hershme të tij, e deri në fazën përmbyllëse që është ajo përmbartimore. Për më tepër, që procesi i kodifikimit në Kosovë ka nisur me miratimin e Kodit të Procedurës Penale, vijimin e punës për hartimin e Kodit Civil, e në këtë drejtim nuk mund të bëjë përjashtim sfera e procedurës civile. Mungesa e kodifikimit të procedurës civile në Kosovë do të sjellë si pasojë edhe vijimin e pasjes së ligjeve të pakonsoliduara, pasi aktualisht qytetarëve nuk u ofrohen versione të përditësuara të ligjeve procedurale, por ata mund të kenë qasje veçmas në ligjin fillestar, e veçmas në ligjet e mëpasme ndryshuese, çka e vështirëson së tepërmi qasjen efektive të publikut në legjislacionin procedural.

Kapitulli 3.3: Hartimi i Kodit të Procedurës Civile të Kosovës

Ky grup punues pas analizës së konsultimeve dhe identifikimit të problemeve të ligjeve aktuale konsideron se opsioni i tretë për ndryshimin e kornizës ligjore përmes hartimit të Kodit të Procedurës Civile është më i përshtatshëm dhe më i pranueshëm me qëllim të zgjidhjes përfundimtare dhe të qëndrueshme të problemit kryesor. Procesi i kodifikimit synon përmbledhjen e ligjeve që rregullojnë të njëjtën lëndë në një ligj të vetëm. Në këtë mënyrë, ky proces ofron më shumë koherencë dhe shmangien e kontradiktave mes instituteve të së drejtës si dhe njësimin e terminologjisë ligjore. Në këtë mënyrë ofrohet më shumë qartësi dhe siguri për të gjithë praktikuesit e së drejtës. Qasja e publikut në rregullat procedurale civile bëhet edhe më i lehtë dhe i arritshëm.

3.3.1. Avantazhet

Sipas përkufizimit që ka fjala kodifikim në legjislacionin e Bashkimit Europian,¹⁸ ai ka të bëjë me procesin e bashkimit të një apo më shumë akteve ligjore dhe ndryshimeve që u janë bërë atyre, në një akt të vetëm të ri ligjor. Kodifikimi ka dy trajta:

- Vertikal: kur një akt ligjor dhe aktet ndryshuese të tij inkorporohen në një akt të ri unik.
- Horizontal: kur 2 apo më shumë akte origjinale që trajtojnë lëndë të lidhura me njëra-tjetrën, si dhe aktet ndryshuese të tyre, shkrihen në një akt të ri unik. Në dallim nga procesi i konsolidimit (kur aktit fillestar ligjor i inkorporohen të gjitha ndryshimet e mëpasme), akti i ri që del nga procesi i kodifikimit, kalon nëpër një procedurë të plotë legjislative dhe zëvendëson aktet që i kodifikon.

¹⁸ <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/codification.html>

Gjatë procesit legjislativ të kodifikimit do të bëhet e mundur që të identifkohen dispozitat ligjore aktuale që janë të paqarta, të dublikuara, apo të pazbatueshme. Po ashtu është e mundur të korrigjohet terminologjia gjuhësore e përdorur në tekstet e vjetra, për ta bërë atë më në përputhje me standardet e gjuhës zyrtare të Kosovës.

Nëpërmjet procedurës së kodifikimit të ligjeve procedurale civile, mundësohet përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit procedural me atë të vendeve të zhvilluara europiane, pasi gjatë këtij procesi mund të përmirësohen institutet procedurale aktuale dhe të inkorporohen edhe institute të reja, siç është edhe mekanizmi për konstatimin e shkëljes së afateve të arsyeshme të gjykimit dhe përmbarimit të çështjeve, i cili është kërkesë e Këshillit të Europës dhe rrjedh nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Hartimi i Kodit të Procedurës Civile ka këto avantazhe:

- 1) Shërben për mënjanimin e ndryshimeve në ligjet ekzistuese dhe inkorporimin (konsolidimin) e të gjitha ndryshimeve në një akt të vetëm të ri, duke bërë edhe përmirësimet përkatëse aty ku është e nevojshme.
- 2) Kodi i Procedurës Civile do të përmirësojë qasjen e publikut në ligjet procedurale, pasi është më i thjeshtë për përdorim.
- 3) Kodi i Procedurës Civile do të vijojë procesin reformues në Kosovë, që ka përfshirë kodifikimin e fushave kryesore të legjislacionit, siç është Kodi i Procedurës Penale apo projekt Kodi Civil.
- 4) Në Kod do të përmirësohet kompetenca e gjykatave rishikuese, duke futur konceptin e gjykimit të disa lloj kërkesash nga një gjyqtar i vetëm, për të mundësuar gjykimin më të shpejtë të lëndëve të ndryshme, e veçanërisht ankimeve ndaj aktvendimeve apo rasteve të tjera të përcaktuara në nenin 6 të Rekomandimit nr. R (95) 5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.
- 5) Me miratimin e Kodit të Procedurës Civile, Kosova do të futet në listën e gjatë të shteteve Europiane që kanë një Kod të Procedurës Civile. Ndër këto shtete po rendisim: Austria, Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Holanda, Zvicra, Portugalia, Polonia, Shqipëria, etj.
- 6) Do të bëhet e mundur miratimi i një mekanizmi zhbllokues për rastet e vonesave të paarsyeshme në gjykimin ose përmbarimin e çështjeve gjyqësore apo përmbarimore.
- 7) Procesi i kodifikimit do të shërbejë si një mundësi e mirë për përmirësimin e aspekteve gjuhësore të dispozitave të ndryshme procedurale, duke i bërë ato më të qarta e më të lehta për tu kuptuar.

3.3.2. Disavantazhet

Nga ana tjetër i vetmi "disavantazh" që ka hartimi i një Kodi të Procedurës Civile, lidhet me vështirësitë teknike në ngritjen e një grupi pune që do të ketë nevojë për një kohë të mjaftueshme për draftimin e këtij Kodi, me qëllim që jo vetëm të bashkojë ligjet e veçanta

aktuale, por edhe të përmirësojë rrënjësisht dispozitat aktuale jo vetëm nga pikëpamja gjuhësore, por edhe nga pikëpamja konceptuale, duke shtuar edhe institutet e tjera të nevojshme që janë kërkesë e sotme e një Kodi modern Procedural Civil.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Opsioni 1: (asnjë ndryshim)

Opsioni 1 pritet të ketë vetëm ndikime negative, pasi nuk mundëson ecjen përpara me harmonizimin, korrektimin dhe reformimin e legjislacionit aktual procedural, duke lënë të paprekura të gjitha problematikat e evidentuara më herët.

Opsioni 2: (ndryshimi i ligjeve të veçanta, pa kodifikim)

Ky opsion ndikon në vijimin e status quo-së në lidhje me vështirësinë e publikut për të pasur qasje efektive në normat procedurale civile. Po ashtu, nëpërmjet këtij opsioni, thjesht do të shtohet një ligj ndryshues më shumë, duke e bërë edhe më të vështirë leximin e normave në fuqi, pasi në çdo rast do të nevojitet që mbahet parasysh teksti fillestar i ligjit, ndryshimi i mëpasshëm dhe ndryshimi i fundit.

Opsioni 3: (Hartimi i Kodit të Procedurës Civile)

Hartimi i Kodit të ri të Procedurës Civile do të ndikojë në qasjen më të mirë të publikut në drejtësinë civile, pasi do të jetë e mundur që normat kryesore të procesit gjyqësor civil apo përmbarimor, të gjenden lehtësisht në një akt të vetëm ligjor, i aksesueshëm lirisht nga kushdo. Kodi nënkupton një strukturë në të cilën vendosen të gjitha rregullat procedurale kryesore që zbatohen gjykatat dhe përmbaruesit. Në këtë drejtim, është shumë më i lehtë orientimi dhe identifikimi i rregullave procedurale kur ato gjenden në një tekst të vetëm ligjor.

Kodi i Procedurës Civile ndikon në strukturën e ligjore në përgjithësi, pasi sëbashku me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Civil, përbën bazën e legjislacionit të një vendi të caktuar. Sigurisht që Kodet në vetvete nuk janë të vetëmjaftueshëm. Ato plotësohen me legjislacion tjetër, i cili rregullon aspekte të tjera të domosdoshme, të cilat nuk mund të përfshihen nëpër Kode, pasi do e rëndonin së tepërmi strukturën dhe kuptueshmërinë e tyre. P.sh: përgjithësisht është e pranuar se rregullat e organizimit të gjykatave, nuk i përkasin Kodit të Procedurës Civile, por një ligji të veçantë për gjykatat.

Kodi i Procedurës Civile, duke përmirësuar qasjen e qytetarëve në ligjet me të cilat gjykatat zgjidhin mosmarrëveshjet e ndryshme, do të ndikojë në përmirësimin në përgjithësi të klimës së të drejtave themelore të njeriut dhe madje edhe në klimën e të bërit biznes. Kjo pasi, Kodet përgjithësisht perceptohen si akte ligjore stabël, të cilët nuk ndryshojnë shpesh. Në këtë drejtim,

është me rëndësi të veçantë strukturimi i Kodit të Procedurës Civile në atë mënyrë që të shmanget sa më shumë të jetë e mundshme ndryshimi i mëvonshëm i tij.

Ndryshimet që synohen të inkorporohen në Kodin e Procedurës Civile, do të krijojnë mekanizma efikasë (të pranuar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut)¹⁹ për trajtimin dhe parandalimin e shkeljes së afateve të arsyeshme të gjykimit të çështjeve të ndryshme si dhe të procedurave përmbarimore.

Nëpërmjet ndryshimeve që propozohet të pësojnë rregullat procedurale që do të inkorporohen në Kodin e Procedurës Civile, do të përmirësohen të drejtat procedurale të palëve nëpërmjet rritjes së transparencës, do të rritet efienca e gjykatave për evadimin e çështjeve gjyqësore, do të formalizohet edhe më shumë një pjesë e procedurës për lëshimin e urdhërpagesës apo për gjykimin e kontesteve me vlerë të vogël, e cila do të mundësojë një qasje më të shpejtë e më të lehtë në drejtësi nga subjektet e ndryshme.

Në përgjithësi mund të thuhet se procesi i kodifikimit bart në vetvete të mirën e mundësisë së përmirësimit rrënjësor të normave procedurale civile, për të inkorporuar zhvillimet më të fundit teknologjike, si dhe standardet më të mira Europiane në fushën e procedurës civile.

Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuar për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuar
Ndikimet ekonomike	Kodifikimi përmirëson klimën të bërit biznes, pasi do të inkorporojë edhe rregulla për gjykimin në distance, e cila është me rëndësi ekonomike për palët.
Ndikimet shoqërore	Rritja e qasjes në drejtësi
Ndikimet mjedisore	Nuk pritet të ketë ndikim në këtë drejtim
Ndikimet në të drejtat themelore	Rritja e qasjes në drejtësi dhe garancitë për një proces të rregullt ligjor
Ndikimi gjinor	Nuk pritet të ketë ndikim në këtë drejtim
Ndikimet e barazisë sociale	Nuk pritet të ketë ndikim në këtë drejtim
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk pritet të ketë ndikim në këtë drejtim
Ndikimet në ngarkesën administrative	Nuk pritet të ketë ndikim në këtë drejtim
Ndikimi i NMV-ve	Nuk ka vlerësim në lidhje me këtë të dhënë

Kapitulli 4.1: Sfida në mbledhjen e të dhënave

Gjatë hartimit të këtij dokumenti nuk janë hasur vështirësi në mbledhjen e të dhënave të nevojshme për shkak se grupi punues ka përfshirë anëtarë të Ministrisë së Drejtësisë dhe të

¹⁹ Çështja Bara dhe Kola *k. Shqipërisë* (Kërkesat nr. 43391/18 dhe 17766/19), vendim i GjEDNj i datës 12.10.2021, bërë përfundimtar më datë 28.02.2022.

Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilët kanë ofruar informata të mjaftueshme për periudhat e mëparshme dhe të dhëna mbi situatën aktuale. Grupi punues po ashtu ka pasur konsultime dhe bashkëpunim me gjithë aktorët tjerë relevant sa i përket mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë donatorët ndërkombëtar.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Palët e interesit në raport me këtë koncept dokument janë: Ministria e Drejtësisë; Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Gjyqtarët që merren më çështje civile, ekonomike dhe administrative, Odat Ekonomike që veprojnë në Kosovës; Avokatët dhe organizatat e shoqërisë civile, etj.

Procesi i konsultimit synon: - Procesi i konsultimit synon marrjen e të gjitha pikëpamjeve nga palët që kanë qenë dhe janë të përfshira në zbatim të ligjeve ekzistuese, duke filluar nga problemet, efektet e shkaktuara në praktikë, si dhe ndryshimet që duhet të parashihen në Kodin e Procedurës Civile.						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikator	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara	KGJK, ZKM, MFPT, ekspertët vendor dhe ndërkombëtar	Takimi publik	E-mail	Janar 2023		Kryesuesi i grupit punues
Konsultimi i institucioneve relevante	KGJK	Takime/intervista me gjyqtarët, përveç atyre që ishin në përbërje të grupit punues	E-mail/thirrje telefonike	Shkurt-Mars 2023		Kryesuesi i grupit punues
Konsultimi paraprak me shkrim	Institucionet e Republikës së Kosovës	Shpërndarja e draftit për konsultim paraprak	E-mail	Prill 2023		Kryesuesi i grupit punues
Konsultimi publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik dhe konsultimi me shkrim	Platforma dhe e-mail	Maj 2023		Kryesuesi i grupit punues

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Në këtë kapitull, krahasohen tri opsionet e mundshme që parashtrihen në këtë koncept dokument, duke nxjerrë në pah domethënien dhe rëndësinë e secilës prej tyre. Opsioni i parë është i pakëshillueshëm, jo vetëm për shkak se nuk sjell asnjë avantazh, por sepse bart të gjitha disavantazhet e status quo-së, të cilat janë evidentuar më herët në këtë Koncept dokument. Opsioni i dytë, ndonëse ka avantazhin që krijon mundësinë për reformim të rregullave procedurale civile, kërkon që ligji ndryshues të prekë shumë dispozita të ligjeve ekzistuese procedurale civile, që më pas sjell disavantazhin e madh që lidhet me qartësinë dhe lehtësinë e qasjes së publikut në ligjet që rregullojnë procedurat e ndryshme civile. Opsioni i tretë paraqitet jo vetëm më i pëlqyeshmi për shkak të rrisë që sjell, por është edhe opsioni që mundëson më së miri bashkimin e avantazheve të opsionit të dytë, me nevojën për të pasur një legjislacion procedural unik, të harmonizuar dhe modern, i cili mund të jetë i qasshëm me lehtësi jo vetëm nga profesionistët e të drejtës, por edhe nga jo juristët.

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për alternativat e ndryshme

Opsioni 1: Ky opsion nuk kërkon kryerjen e ndonjë veprimi, por plotësohet me mosveprim.

Opsioni 2: Ky opsion kërkon ngritjen e një grupi pune, për identifikimin e nevojave konkrete për ndryshim në ligjet e veçanta që rregullojnë lëndën e procedurës civile në Kosovë. Ky grup pune duhet të ketë pjesë të tij profesionistë të fushës së drejtësisë (gjyqtarë, avokatë, përmbarues, noterë, juristë të administratës publike, pedagogë të Fakulteteve të Drejtësisë, ekspertë ndërkombëtarë që janë njohës të procedurës civile). Në këtë grup pune do të draftohen ligjet ndryshuese, duke propozuar në respekt të teknikës legjislative që vepron në Kosovë, dispozita ligjore konkrete që duhet të përfshihen në ligjet ndryshuese. Për këtë punë nevojitet vendosja e një afati të arsyeshëm për pasjen e drafteve të para, konsultimin e tyre, rishikimin e drafteve dhe miratimin përfundimtar të tyre.

Figura 7: Plani i zbatimit për Opsionin 2

Qëllimi i politikës	Drejtësi në kohë dhe qasje në drejtësi.		Shifra e kostos së pritur
Objektivi strategjik	Përmirësimi dhe kodifikimi i ligjeve ekzistuese në fushën procedurale civile dëeri në 2025		
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/ departamenti përgjegjës		
Objektivi	Produkt		

Specifik 1 Reformimi i legjislacionit te fushës procedural civile konform ndryshimeve e edhe te fushave tjera materiale te se drejtes civile	ti 1.1 Kodi i Procedures Civile i miratuar		2023	2024	2025	2026	2027	Institucioni /departamenti përgjegjës		
		Aktiviteti 1.1.1 Hartimi i Kodit të Procedures Civile		x					MD	
		Aktiviteti 1.1.2 Konsultimi me palët e interesit.		x					MD	
		Aktiviteti 1.1.3 Konsultimi ndër ministrior dhe publik përmes platformës përkatese onloje		x					MD	
		Aktiviteti 1.1.4 Prezantimi i Projekt Kodit të Procedures Civile në Kuvendin e Kosovës				x				

		Aktiviteti 1.1.4 Informimi i palëve të interesuara rreth Kodit të Ri të Procedures Civile			x				
--	--	---	--	--	---	--	--	--	--

Opsioni 3: Njësoj si opsioni i dytë, edhe në alternativën e tretë nevojitet ngritja e një grupi pune, për draftimin nga e para, duke inkorporuar edhe dispozitat aktuale të ligjeve të veçanta, në një draft të Kodit të Procedurës Civile të Kosovës. Ky grup pune duhet të ketë pjesë të tij profesionistë të fushës së drejtësisë (gjyqtarë, avokatë, përmbaues, noterë, juristë të administratës publike, pedagogë të Fakulteteve të Drejtësisë, ekspertë ndërkombëtarë që janë njohës të procedurës civile). Në këtë grup pune do të draftohen Kodi i Procedurës Civile të Kosovës. Për këtë qëllim nevojitet vendosja e një afati të arsyeshëm për pasjen e draftit të parë, konsultimin e tij me grupet e interesit, rishikimin e draftit nga grupi i punës dhe miratimin përfundimtar të tij.

Figura 8: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i politikës	Drejtësi Në kohë dhe qasje në drejtësi.							Shifra e kostos së pritur	
Objektivi strategjik	Përmirësimi dhe kodifikimi i ligjeve ekzistuese në fushën procedurale civile dëri në 2025								
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/ departamenti përgjegjës								
Objektivi Specifik 1 Reformimi i legjislacionit të fushës procedural civile konform ndryshimeve edhe të fushave	Produkti 1.1 Kodi i Procedures Civile i miratuar		2023	2024	2025	2026	2027	Institucioni / departamenti përgjegjës	
	Aktiviteti 1.1.1 Hartimi i Kodit të Procedures			x				MD	

tjera materiale te se drejtes civile	Civile							
	Aktiviteti 1.1.2 Konsultimi me palët e interesit.		x					MD
	Aktiviteti 1.1.3 Konsultimi ndër ministror dhe publik përmes platëforme s përkatëse onloje		x					MD
	Aktiviteti 1.1.4 Prezantimi i Projekt Kodit të Procedures Civile në Kuvendin e Kosovës			x				
	Aktiviteti 1.1.4 Informimi i palëve të interesuara rreth Kodit të Ri të Procedures Civile			x				

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Tre opsionet që diskutohen në këtë KD janë ai i mos ndryshimit, ai i ndryshimit të ligjeve procedurale por pa realizuar Kodifikim, si dhe opsioni i kodifikimit të legjislacionit procedural civil, nëpërmjet hartimit të Kodit të Procedurës Civile të Kosovës. Alternativa e tretë është më e mira, pasi vjen në një linjë me iniciativat e tjera ligjore në Kosovë (hartimi i Kodit Penal, atij të Procedurës Penale, projekt Kodi Civil), ndikon në rritjen e qasjes së profesionistëve dhe publikut në normat procedurale civile, si dhe mundëson konsolidimin e legjislacionit procedural civil në një akt të vetëm ligjor.

Figura 9: Krahasimi i opsioneve

Metoda e krahasimit:			
Ndikimet relevante positive	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Përmirësimi i ligjeve ekzistuese	Opsioni 3: Hartimi i Kodit të Procedurës Civile
		Ndryshimet dhe harmonizimi i ligjeve ekzistuese në formën e rregullimit aktual.	Qasje më e mirë e publikut në drejtësinë civile.
		Qasjenë drejtqësi për qytetarët	Normat procedurale do të kodifikohen në një akt të vetëm ligjor
		Gjykim në kohë të arsyeshme.	Identifikim më i lehtë i normave procedurale duke rritur sigurinë juridike.
			Harmonizim më i mirë i institutive të së drejtës procedurale.
			Rritet eficaenca e gjykatave për gjykimin e çështjeve në afat.
			Harmonizimi me standardet ndërkombëtare në fushën e procedurës civile që nuk janë pjesë e ligjeve ekzistuese.
Ndikimet relevante negative			
	Nuk lejon harmonizimin, korrektimin dhe reformimin e legjislacionit procedural aktual.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shtohen ligjet ndryshuese me natyrë procedurale. 2. Vështirësohet qasja efektive në 	Nuk ka.

				drejtësi. 3. Vështirësohet identifikimi i nomrave procedural në fuqi					
Kostot relevante	=====			=====			=====		
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1 0	Viti 2 0	Viti 3 0	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1 30,007,121.00	Viti 2 34,685,308.00	Viti 3 35,988,923.00
Përfundimi				Ofron përfitime pa kosto shtesë					

Kapitulli 7: Përfundimet dhe vizioni për strukturën e Kodit të Procedurës Civile të Kosovës

Në përfundim të këtij Koncept dokumenti për Kodin e Procedurës Civile të Kosovës, mund të thuhet se hartimi i një Kodi të Procedurës Civile në Kosovë është një domosdoshmëri dhe një nevojë që vjen jo vetëm nga trendi i përgjithshëm i kodifikimit të legjislacionit penal, civil apo procedural penal në Kosovë, por edhe nga nevoja për ta modernizuar legjislacionin procedural civil, nëpërmjet futjes së instituteve të reja procedurale civile, ndryshimit të atyre ekzistues dhe përmirësimit tërësor gjuhësor të terminologjisë së përdorur. Qëllimi final është të krijohet një Kod Procedure Civile, i mirë shkruar, bashkëkohor, në përputhje me standardet më të mira Europiane, i plotë dhe nëpërmjet të cilit të mundësohet shqyrtimi i drejtë, i shpejtë dhe eficient i mosmarrëveshjeve apo çështjeve të tjera që janë në kompetencën e gjykatave, si dhe procesin përbarimor.

Siç edhe nënkupton vetë procesi i kodifikimit, do të bëhet një bashkim i tre ligjeve kryesore që ekzistojnë sot në Kosovë e që normojnë procedurën civile, që janë ligji “Për Procedurën Kontestimore”, ligjit “Për Procedurën Jokontestimore” dhe ligjit “Për Procedurën Përbarimore”. Ligje apo pjesë të tjera ligjesh të veçanta mund t’i bashkohen Kodit, varësisht nevojës strukturore dhe organizative që do të lindë. Synimi në këtë proces kodifikues është që të ruhen rregullat aktuale të parashikuara në ligjet e mësipërme dhe të bëhen përmirësime apo shtesa vetëm aty ku është e nevojshme, referuar standardeve më të mira Europiane. Duke

vepruar në këtë mënyrë Kodi i ri i Procedurës Civile do të ruajë identitetin vendor dhe nuk do të jetë “gjë e huaj” për praktikuesit e të drejtës. Kjo ka avantazhin që gjithë praktika gjyqësore dhe eksperiencia e krijuar ndër vite do të ruhet, duke u mundësuar një zhvillim gradual i legjislacionit. Opsioni për të bërë një Kod të Procedurës Civile që të mos ketë asnjë ngjashmëri me rregullat ekzistuese është jo vetëm i papërshtatshëm, por edhe i dëmshëm në terma afatshkurtër dhe afatmesëm. Pra Kodi i ri i Procedurës Civile do të jetë një evoluim i rregullave aktuale të procedurës civile që gjenden të shpërndara në disa ligje të veçanta. Tek ligji “Për Procedurën Përmbartimore” mund të mbeten vetëm dispozitat organizative të shërbimit përmbartimor privat, të cilat janë të tepërta të përfshihen në Kodin e Procedurës Civile.

Struktura e Kodit të Procedurës Civile të Kosovës mendohet të jetë si më poshtë vijon. Kodi do të ketë 5 pjesë:

1. PJESA I do të titullohet “DISPOZITA TË PËRGJITHSHME”
2. PJESA II do të titullohet “GJYKIMI NË SHKALLË TË PARË”
3. PJESA III do të titullohet “GJYKIMET E POSAÇME”
4. PJESA IV do të titullohet “MJETET E ANKIMIT”
5. PJESA V do të titullohet “PROCESI PËRMBARTIMOR”

Në vija të përgjithshme mund të themi se tek PJESA I do të përfshihen parimet e përgjithshme të procedurës civile, ku do të inkorporohen dispozitat aktuale të ligjit “Për Procedurën Kontestimore”, ligjit “Për Procedurën Jokontestimore” dhe pjesërisht ligjit “Për Procedurën Përmbartimore”, si dhe do të vendosen disa parime të përgjithshme në lidhje me gjykimin në distancë dhe në lidhje me provat elektronike. Po ashtu do të vendosen rregullat për juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave të ndryshme, duke harmonizuar dispozitat që gjenden në ligjet e veçanta. Do parashikohen rastet e përjashtimit të gjyqtarit, rregullat për palët, bashkëndërgjyqësit dhe përfaqësuesit e tyre, aktet dhe afatet procedurale të palëve dhe gjykatës, rivendosja në afat, llojet e gjykimeve që mund të zhvillojnë gjykatat (shkresor apo në seancë gjyqësore publike, aktgjykimi për shkak të mungesës, etj), përpilimi i akteve procedurale nga gjykata, rregullat për njoftimin e akteve, përfshirë edhe njoftimin elektronik. Do parashikohen rregullat për për padinë apo kërkesën që i drejtohet gjykatës, përcaktimin e vlerës së tyre, pozita e prokurorit apo avokaturës së shtetit në proceset gjyqësore civile, etj.

Më tej, në vija të përgjithshme mund të themi se tek PJESA II do të përfshihen rregullat e detajuara për kushtet formale të paraqitjes së kërkesëpadisë apo kërkesës në gjykatë, ku do të inkorporohen dispozitat aktuale të ligjit “Për Procedurën Kontestimore”, ligjit “Për Procedurën Jokontestimore”, veprimet paraprake apo përgatitore që kryen gjykata. Seanca gjyqësore, rregullat për zhvillimin e saj, kompetencat e gjykatës për disiplinimin e palëve apo përfaqësuesve të tyre (gjobat). Do trajtohen mjetet e mbrojtjes në dispozicion të të paditurit (prapësimi, kundërpadia), pjesëmarrja e personave të tretë në procesin gjyqësor civil, afatet procedurale për ushtrimin e të drejtave në proces nga palët apo personat e tretë. Rastet e ndërprerjes (pezullimit) të gjykimin apo pushimit të tij, rregullat për ndihmën juridike midis

gjykatave vendore (letërporosia), rregullat për sigurimin e padisë, mjetet provuese dhe marrja e provave, etj.

PJESA III do të inkorporojë rregullat aktuale të neneve 474-510 të ligjit "Për Procedurën Kontestimore", si dhe rregullimet e tjera të ligjit "Për Procedurën Jokontestimore". Këto rregulla prevalojnë ndaj rregullave të pjesës II, përveç nëse parashikohet e kundërta ose ka mungesë të një rregullimi specifik. Në këtë pjesë do të përfshihen rregullat për gjykimin e çështjeve personale dhe familjare, rregullimi i çështjeve të trashëgimisë, pjesëtimi i sendeve në bashkëpronësi, caktimi i masës së kompensimit për pasurinë e shpronësuar. Në këtë pjesë do të vlerësohet nëse është nevoja që një pjesë e kompetencave të gjykatës në lidhje me përpilimin dhe vërtetimin e përmbajtjes së dokumenteve, tu hiqen atyre dhe t'i kalohen noterëve. Po ashtu depozita gjyqësore mund të mos parashikohet më si një tagër i gjykatave. Në këtë pjesë, mund të përfshihen edhe rregulla të veçanta që parashikohen në ligje të posaçme, me anë të të cilave parashikohen procedura konkrete për trajtimin nga gjykata të çështjeve të tjera. Pjesë e kësaj pjese do të jetë edhe procedura e posaçme sipas mekanizmit të posaçëm që synohet të krijohet, për shmangien e cenimit të afateve të arsyeshme në gjykimin e çështjeve nga gjykatat dhe përmbarimin e çështjeve nga shërbimi përmbarimor, etj.

PJESA IV do të inkorporojë dispozitat aktuale të ligjit "Për Procedurën Kontestimore" (nenet 176-251) dhe disa dispozita nga ligji "Për Procedurën Jokontestimore", që kanë të bëjnë me mjetet e ankimit (goditjes), të cilat janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Këtu do të parashikohet edhe procedura e gjykimit në apel apo në Gjykatë të Lartë të disa lloj aspektesh procedurale të ankimit, nga një gjyqtar i vetëm i këtyre gjykatave. Do të shtrohet për diskutim nevoja e pasjes së institutit të "Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë", si dhe nevoja për ridimensionim të rolit të Prokurorit publik në rastet e drejtësisë midis privatëve, etj.

PJESA V do të inkorporojë dispozitat e ligjit "Për Procedurën Përmbarimore" duke lënë jashtë vetëm pjesën e tretë të këtij ligji që i përket dispozitave që lidhen me organizimin strukturor të përmbaruesve privatë. Këtu do të harmonizohet procedura përmbarimore në bazë të dokumenteve të besueshme me procedurën e posaçme për lëshimin e urdhërpagesës që është parashikuar në Pjesën III të Kodit të Procedurës Civile. Synimi është që të shmanget sa të jetë e mundur mbivendosja e procedurave të ndryshme, duke ravijëzuar qartë kufijtë midis dy instrumenteve në dispozicion të personit që është titullar i dokumentit të besuar.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ²⁰	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		X			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		X			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		X			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		X			
	A do të krijohen biznese të reja?		X			
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		X			
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		X			
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit? X		X			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		X			

²⁰ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		X			
Investimet	A pritët që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		X			
	A pritët që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		X			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		X			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		X			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		X			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		X			
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		X			
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		X			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		X			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		X			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		X			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		X			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		X			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X			

	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X			
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		X			
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		X			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		X			
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		X			

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ²¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		X			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		X			
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		X			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		X			
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte		X			

²¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

	të rrezikshme?					
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		X			
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		X			
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		X			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		X			
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		X			
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		X			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		X			
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		X			
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		X			
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		X			
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		X			
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		X			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		X			
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		X			
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		X			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		X			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		X			

	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?		X				
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?		X				
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		X				
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		X				
Shëndeti dhe siguria publike ²²	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		X				
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		X				
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		X				
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		X				
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		X				
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		X				
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?						
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të xpërcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo		X				

²² Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikimex mjedisore.

	rajon)?					
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		X			
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		X			
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		X			
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?		X			
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		x			

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur I lartë/i ulët	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit I lartë/i ulët	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		X			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		X			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		X			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		X			

Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		X			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		X			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		X			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		X			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		X			
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?x		x			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		X			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		X			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?		X			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		X			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		X			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		X			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, gypuri etj.)?		X			

Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		X			
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		X			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		X			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?x		x			
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		X			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		X			
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		X			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		X			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		X			

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur I lartë/i ulët	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit I lartë/i ulët	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			

Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?	Po		I lartë		
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?	Po		I lartë		
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?	Po		I lartë		
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?	PO				
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?	Po		I lartë		
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?	Po		I lartë		
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?	Po		I lartë		
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?	Po		I lartë		
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	Po			I ulët	
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	Po		I lartë		
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	Po			I ulët	
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		Jo	I lartë		
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?	Po		I lartë		
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?	Po		I lartë		
Trajtimi i barabartë ²³	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	Po		I lartë		

²³ Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*

	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		Jo			
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?	Po		I lartë		
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?	Po		I lartë		
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		Jo			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?	Po		I lartë		
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		Jo			
	A ndikohet qasja në drejtësi?	Po		I lartë	I lartë	